

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5475
E hënë, 14 maj 2018
çmimi 0.40 €

Pacolli mbështet idenë e krijimit të zonës ekonomike amerikane

FAQE 3

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se mbështet fuqishëm idenë e krijimit të zonës ekonomike amerikane, e cila do të tërheqë kompanitë amerikane për të ardhur në Kosovë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE" GUVERNATORI I BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS (BQK), FEHMI MEHMETI

Pritet të ketë ulje të normave të interesit

- Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë stabil

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se duke marrë parasysh trendin e vazhdueshëm të uljes së normave të interesit dhe konkurrencën gjithnjë në rritje të sektorit bankar, vlerëson se bankat do të vazhdojnë të reflektojnë për uljen e normave të interesit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mehmeti ka theksuar se normat ekzistuese janë përgjithësisht të njëjta me ato të vendeve të tjera. Ai ka thënë se sek-

tori bankar në Kosovë vazhdon të jetë stabil. Guvernatori Mehmeti ka thënë se të gjitha bankat janë likuide, stabile dhe kanë burime të mjaftueshme të financimit të aseteve. Ai ka treguar se në periudhën janar - prill të këtij viti Divizioni i Ankesave ka pranuar gjithsej 146 ankesa kundër bankave komerciale



Kurteshi: Tryezat e deritanishme nuk kanë prodhuar asgjë të re

Lëvizja Vetëvendosje ende nuk ka vendosur nëse do ta organizojë apo jo tryezën e tretë me radhë të partive politike. Deputeti i kësaj lëvizje, Ismajl Kurteshi, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se vendimi për këtë çështje pritet të merret në mbledhjen e kryesisë së Lëvizjes

Vetëvendosje. Megjithatë, ai ka thënë se tryezat e deritanishme nuk kanë pasur efekt. Kurteshi ka vlerësuar se mbajtja e tryezave politike do të kishte kuptim vetëm nëse ato kanë për qëllim arritjen e një pajtueshmërie për t'iu qasur të gjithë njësoj problemeve të mëdha kombëtare



Interesim i madh i të rinjve për t'u bërë pjesë e policisë

Mijëra të rinj kanë shprehur interesim për t'u bërë pjesë e Policisë së Kosovës. Zëdhënësi i Policisë, Daut Hoxha, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se deri në përmbylljen e konkursit për pranimin e zyrtarëve

policorë (më 10 maj) janë pranuar rreth 17 500 aplikacione. Ai ka treguar se ky numër mund të jetë më i madh meqenëse ende është në proces regjistrimi i aplikacioneve në sistem

FAQE 5



AKTUALE

PUSHKËT E TAHIR DHE NEBIH MEHËS ISHIN ZGJIM KOMBËTAR F. 10

MBI 15 000 TË RINJ PËRKRAHIN VLERAT E PDK-së F. 7

MJEKËT SPECIALISTË NUK PREFEROJNË PUNËSIMIN NË SPITALET RAJONALE F. 6

EKONOMI

RESHITAJ PREMTON NDËRPRERJEN E LEJEVE TË REJA PËR HIDROCENTRALET NË KOSOVË F. 9

KULTURË

MINISTRI GASHI: KINEMATOGRAFIA E KOSOVËS, SHEMBULL I SUKSESIT F. 16

SPORT

BESA, BINDËSE KUNDËR VLLAZINISË F. 18

'SHAOOLINAT' FITOJNË TURNIRIN 'DEMUSH MAVRAJ' F. 18

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi: Pavarësinë e Kosovës e kemi 'vulosur' vetë

BEOGRAD, 13 MAJ - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se nuk ka frikë nga sanksionet e mundshme të Perëndimit në procesin e zgjidhjes së çështjes së Kosovës, por më shumë e shqetësojnë problemet e tilla, siç është ikja e popullit nga Serbia dhe shkalla ulët e lindshmërisë. Ai ka thënë se vetë Serbia, me politikën e saj të gabuar, e ka "vulosur" pavarësinë e Kosovës.

Vuçiqi ka kujtuar se për këtë situatë dhe rrethanat shumë të këqija në të cilat po zgjidhet çështja e Kosovës janë derdiku përgjegjës, duke pasur parasysh politikën e gabuar të Serbisë. Sipas tij, disa lëvizje të Serbisë ia kanë dhënë vulën në zarfin e Pavarësisë së Kosovës. Presidentin serb, siç ka shkruar gazeta serbe "Blic", e kanë pyetur gazetarët lidhur me informacionet për një marrëveshje ndërmjet Evropës

dhe ShBA-së për Kosovën para pak ditësh në Uashington, respektivisht për "Dokumentin e Uashingtonit". Ai ka theksuar se nuk ka parë kurrfarë dokumenti nga takimi i fundit i vendeve të Kuintit në Uashington, duke thënë se "marrëveshja që ka mundur të arrihet atje nuk mund të jetë një surprizë e madhe, sepse janë vendet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës".



Samiti BE - Ballkan, nën hijen e sfidave të Trumpit në Evropë

Në samitin e së enjtes në Bullgari evropianët do të përpiqen t'u japin një shtysë të re marrëdhënieve me Ballkanin Perëndimor. Ky samit rrezikon të eklipsohet nga debatet për sfidat diplomatike në BE të presidentit amerikan Donald Trump

BRUKSEL, 13 MAJ - Evropianët do të përpiqen t'u japin një shtysë të re marrëdhënieve me Ballkanin Perëndimor gjatë një samiti të enjten në Bullgari, që rrezikon të eklipsohet nga debatet për sfidat diplomatike në BE të presidentit amerikan, Donald Trump.

Takimi i liderëve evropianë me homologët e tyre të gjashtë shteteve, Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Serbi, Mali i Zi, Maqedoni dhe Kosovë, synon të vendosë lidhje të ngushta me këtë rajon ku Rusia po përpiqet ta zgjerojë ndikimin e saj.

Por, fillimisht 28 shtetet anëtare parashikojnë të diskutojnë mes tyre të mërkurën në mbledhje në Sofje, për përgjigjen që do t'i japin ShBA-së pas vendimeve që ajo mori për tërheqjen nga marrëveshja për bërthamoren iraniane dhe për të mos i akorduar BE-së përjashtimin e përherëshëm nga tarifatat doganore për çelikut dhe aluminin. "Politikat e Donald Trumpit për marrëveshjen iraniane dhe tregtinë do të përballen me një qëndrim të përbashkët evropian. Liderët e BE-së do të fokusohen në dy çështje në Sofje, njoftoi presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, pas

vendimit mjaft përçarës amerikan lidhur me Iranin.

Ndërsa përkeqësimi i marrëdhënieve transatlantike është shqetësues, e ardhmja e tyre me Ballkanin mishëron gjithashtu sfida kyçe për kontinentin e vjetër. Ballkani ka tmerrësisht nevojë për një perspektivë evropiane, në të kundërt ne do t'i ripërjetojmë të gjitha të këqijat që kemi kaluar gjatë viteve '90, të përgjakura nga luftërat në rajon, paralajmëroi të premten presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker.

Ekzekutivi evropian paraqiti nga mesi i muajit prill strategjinë për t'u dhënë këtyre shteteve një perspektivë të besueshme për zgjerimin, ndërsa bisedimet e anëtarësimit kanë nisur deri më tani vetëm me Serbinë në vitin 2014 dhe Malin e Zi në vitin 2012, ndërsa Junckeri shprehet besimplotë për t'u bërë anëtarë të Unionit deri në 2025-n.

Rajoy mungon

Brukseli propozon tashmë që shtetet anëtare ta pranojnë nisjen zyrtare të negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe ish-



Republikën jugosllave të Maqedonisë, për t'i shpërblyer përparimet e tyre në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Nga ana tjetër, qëndrimet e Komisionit për Bosnjë e Hercegovinë dhe veçanërisht Kosovën janë më pak pozitive. BE-ja është e shqetësuar për bllokimet e vazhdueshme të procesit të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe Kosovën.

Çështja e Kosovës është veçanërisht e ndërlikuar për 28-shen. Pesë prej tyre - Spanja, Greqia, Qiproja, Sllovakia dhe Rumania - nuk e njohin shpalljen e pavarësisë prej saj në vitin 2008. Nga ana tjetër, kreu i Qeverisë spanjolle, Mariano Rajoy, do të mungojë në samitin e së enjtes për ta shfaqur qëndrimin e tij kundër.

Në përgjithësi disa shtete, përf-

shirë Francën, nuk duan të pranojnë shumë shpejt anëtarësime të reja në BE të vendeve të Ballkanit.

Në projektkonkluzionet e samitit, të konsultuara nga AFP-ja, shtetet anëtare të BE-së shprehin mbështetjen e tyre të qartë për perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit, por shmanjin në mënyrë të kujdesshme përdorimin e fjalëve "anëtarësim" apo "zgjerim".

Teksti thekson nevojën për t'i përmirësuar lidhjet nëpërmjet investimeve në infrastrukturën e transportit, shkëmbimet kulturore dhe arsimore, si dhe forcimin e lidhjeve përbashkëta të sfidave të përbashkëta si siguria dhe migracioni.

Rusia, agresive

Përfundimet e përgatitura nga 28-ët nuk përmendin as çështjen

e ndikimit rus, nëse kjo është një mënyrë e tërthortë e angazhimit për të punuar me shtetet e Ballkanit kundër keqinformimit dhe veprimtarive të tjera hibride. Përballë hezitimit evropian, liderët e rajonit paralajmëruan se Rusia, si Kina dhe Turqia, do të përfitonin nga një periudhë shumë e gjatë në dhomën e pritjes së BE-së për t'i ankoruar më së miri interesat e tyre në rajon. "Prej kohësh, interesat e Perëndimit dhe Rusisë kryqëzohen këtu, si në periudhën e Luftës së Ftohtë, por Rusia synon ta zgjerojë ndikimin e saj në rajon në një mënyrë shumë më agresive", thotë Aleksandar Popov, drejtor i Qendrës për Rajonalizimin e Serbisë.

Rusia ka rritur praninë e saj mediatike në rajonin e Ballkanit këto vitet e fundit, por influenca e saj nuk është konkretizuar ende në planin politik apo ekonomik. Kandidatët pro-rusë nuk arritën ta merrnin pushtetin në Malin e Zi, i cili iu bashkua vitin e fundit NATO-s, pavarësisht prej kundërshtimit të Moskës, si dhe në Maqedoni ku një nacionalist i mbështetur nga Moska humbi zgjedhjet në favor të një pro-perëndimori.

Për sa i përket Serbisë, Rusia gjithmonë është konsideruar si një aleate e rëndësishme, por niveli i investimeve ruse mbetet simbolik krahasuar me ato të BE-së dhe shteteve të saj anëtare. (atsh)

Xhaferi: Ligji për gjuhën shqipe do të dërgohet për publikim në Gazetën Zyrtare

SHKUP, 13 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, ka thënë se Ligji për përdorimin e gjuhëve do të dërgohet për publikim në Gazetën Zyrtare, kur ai do të vlerësojë se është koha e duhur, por nuk ka precizuar kur kjo mund të

ndodhë.

Në një intervistë për "Radio Evropa e Lirë", ai ka thënë se duke marrë parasysh se nuk ka afate ligjore, ai ka thënë se kur do të jetë koha e duhur ligji do të publikohet në Gazetën Zyrtare. Ai nuk dëshiron t'i komentojë

zërat se partia shqiptare në pushtet, BDI-ja, është duke kalkuluar me Ligjin e gjuhëve dhe është duke luajtur lojën 'ftohtë-nxehtë' dhe në rast të zgjedhjeve të reja parlamentare, sërish ta aktualizojë gjuhën shqipe. "Nuk dua të komentoj

atë që thoni ju. Mendoj se ky nuk është qëndrim dhe kalkulum i BDI-së, as e ndonjë partie tjetër, pasi ligji tashmë është sjellë për herë të dytë dhe nuk ka asnjë kalkulum që të bëhet ajo që thoni", ka thënë Xhaferi.



Është mbyllur konkursi për pranimin e zyrtarëve policorë

Interesim i madh i të rinjve për t'u bërë pjesë e policisë

Mijëra të rinj kanë shprehur interesim për t'u bërë pjesë e Policisë së Kosovës. Zëdhënësi i Policisë, Daut Hoxha, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se deri në përmbylljen e konkursit për pranimin e zyrtarëve policorë (më 10 maj) janë pranuar rreth 17 500 aplikacione. Ai ka treguar se ky numër mund të jetë më i madh meqenëse ende është në proces regjistrimi i aplikacioneve në sistem. Kurse ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, u ka bërë thirrje institucioneve t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e policisë lidhur me pagën dhe sigurimin shëndetësor

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË 13 MAJ - Të rinjtë e Kosovës kanë shprehur interesim të madh për t'u bërë pjesë e Policisë së Kosovës. Në konkursin për pranimin e zyrtarëve policorë, i cili është mbyllur më 10 maj, deri më tani janë evidentuar rreth 17 500 aplikacione.

Zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Daut Hoxha, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky numër mund të jetë edhe më i madh. "Konkursi për zyrtarë policorë është mbyllur më 10 maj. Deri me këtë datë janë pranuar rreth 17 500 aplikacione. Meqenëse ende është në proces regjistrimi i aplikacioneve në sistem dhe vetëm pas regjistrimit të të gjitha aplikacioneve dihet numri i saktë, sapo të përfundojë procesi i tërësishëm i regjistrimit do të njoftoheni me kohë. Pyetja se sa është numri që do të pranohen në polici, kjo varet nga nevojat operative të Policisë së Kosovës", ka thënë Hoxha.

Ai ka treguar edhe arsyen pse kaq numër i madh i të rinjve kanë shprehur dëshirën të jenë pjesë e këtij institucioni. "Policia e Kosovës si institucion kryesor i zbatimit të ligjit në vazhdimësi është vlerësuar si një nga institucionet më profesionale dhe të besueshme për qytetarët, prandaj edhe interesimi i të rinjve dhe të rejave nga të gjitha komunitetet ka qenë mjaft i madh për t'u bërë pjesë e Policisë së Kosovës

dhe për t'i shërbyer vendit dhe qytetarëve", është shprehur ai. Sipas Hoxhës, informimi i kandidatëve lidhur me çdo fazë të testeve do të publikohet në uebfaqen e Policisë së Kosovës, në tabelat e shpalljeve nëpër drejtoritë rajonale dhe stacionet policore përkatëse. Në konkurset e policisë deri më tani çdoherë ka pasur interesim

të madh të të rinjve, derisa ky institucion vazhdimisht ka gëzuar besim të lartë tek qytetarët, duke u renditur krahas Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) si një prej institucioneve më të besueshme në Kosovë. Mirëpo, së fundi, Sindikata e Policisë së Kosovës ka shtuar kërkesat ndaj Qeverisë për përmirësimin e kushteve të policisë. Ndër kërkesat kryesore të tyre janë rritja e pagave dhe gjetja e një zgjidhje për sigurimin shëndetësor të pjesëtarëve policorë. Këtyre kërkesave krahe u ka dalë edhe ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, i cili u ka bërë thirrje institucioneve që urgjentisht të gjejnë një zgjidhje për sigurimin shëndetësor dhe jetësor të policëve. Ai ka thënë se në këtë aspekt Policia e Kosovës është më se keqi jo vetëm në Evropë, por dhe në botë. "Fatkeqësisht,

kjo është e vërtetë. Duhet gjetur mënyrën që policëve t'u rriten pagat. Sindikata e Policisë së Kosovës ka qenë shumë bashkëpunuese me të gjitha qeveritë e deritanishme. Unë ua përcjell një selam politikanëve që janë në pushtet, sepse edhe unë jam njëfarë politikani, por nuk jam në pushtet, që të mos e sprovonë durimin e policisë. E njoh mirë këtë institucion dhe ata njerëz që janë shumë të devotshëm, të përkushtuar. Aty ndoshta është pjesa më patriotike e vendit e cila vazhdon të shërbejë më shumë mbi bazën e idealit sesa mbi bazën materiale", ka thënë Selimi. Sipas tij, Qeveria nuk duhet ta sprovonë Sindikatën e Policisë së Kosovës. "Policinë nuk duhet sprovuar duke e detyruar të kalojë në sjellje sindikale që nuk i bën mirë vendit. Është e nevojshme të gjendet një zgjidhje për sig-

urimin dhe pagat e policëve, sepse këto dy çështje janë vitale dhe emergjente. Kosovës i ka mbetur policia si një prej segmenteve më stabile, prandaj nuk është mirë që ky segment ta humbë durimin", ka thënë Selimi.

Kandidatët që kanë aplikuar për zyrtarë policorë në Policinë e Kosovës duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, të jenë të moshës 18 deri në 30 vjeç, ta kenë të përfunduar shkollimin e mesëm, të jenë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale, të mos jenë të dënuar për ndonjë vepër penale, të mos kenë në vend të dukshëm tatuazh, si dhe të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike. Në testimin e tyre ata do t'i nënshtrohen testit me shkrim, testit të aftësive fizike, intervistës, testit psikologjik, kontrollimit mjekësor dhe verifikimit të së kaluarës.



Hoxhaj, Vuçiqit: Pavarësia e ka vulën e popullit të Kosovës



PRISHTINË, 13 MAJ - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka reaguar ndaj deklaratës së presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka thënë se shteti serb ka vulosur pavarësinë e Kosovës.

Hoxhaj ka thënë se pavarësia është vulosur nga vendosmëria dhe sakrifica e popullit të Kosovës. "Pavarësia e Kosovës është vulosur nga vullneti, sakrifica dhe vendosmëria e njerëzve, jo nga politika e

gabuar e Serbisë. Pavarësia jonë nuk është një triumf mbi Serbinë, por një e drejtë legjitime për të ekzistuar, si qytetarë dhe si shtet", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, flet për tryezat e partive politike, në të cilat temë janë çështjet kombëtare

Kurteshi: Tryezat e deritanishme nuk kanë pr

Lëvizja Vetëvendosje ende nuk ka vendosur nëse do ta organizojë apo jo tryezën e tretë me radhë të partive politike. Deputeti i kësaj lëvizje, Ismajl Kurteshi, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se vendimi për këtë çështje pritet të merret në mbledhjen e kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje. Megjithatë, ai ka thënë se tryezat e deritanishme nuk kanë pasur efekt, për faktin se kanë qenë shterpe dhe nuk kanë prodhuar asgjë të re. Kurteshi ka vlerësuar se mbajtja e tryezave politike do të kishte kuptim vetëm nëse ato kanë për qëllim arritjen e një pajtueshmërie për t'u qasur të gjithë njësojë problemeve të mëdha kombëtare

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 MAJ - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Ismajl Kurteshi, ka bërë me dije të dielën se kjo parti ende nuk ka vendosur nëse do ta organizojë apo jo tryezën e tretë me radhë të partive politike. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se vendimi për këtë çështje do të merret në mbledhjen e sotme të kryesisë së Vetëvendosjes. "Sot (e hënë) është mbledhja e kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje në të cilën do të shqyrtohet çështja e tryezës politike, pastaj kryesia do të deklarohet nëse do ta thërrasim apo jo tryezën. Nëse veç vendosim ta thërrasin tryezën, po në këtë mbledhje do të vendoset edhe për çështjet të cilat do të duhej të diskutohen. Sidoqoftë, në tryeza duhet të diskutohet për

çështje që janë të rëndësishme për vendin, dhe jo për zgjedhje e për platforma për bisedime me Serbinë", ka deklaruar Kurteshi, duke shtuar se kryesia e Lëvizjes Vetëvendosje vendos edhe për ftesat eventuale drejtuar subjekteve politike. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që në këtë tryezë të ftohet edhe PDK-ja. "Nëse tryeza parasheh mbledhjen e të gjithë

faktorëve politikë dhe nëse të gjithë janë të gatshëm që për hir të interesave të vendit të heqin dorë nga këto kërkesa dhe platformat që i kanë shpallur deri më tash, mendoj se do të ishte mirë të ftohen të gjitha subjektet politike. Por, vendimet tek ne merren me vota në kryesi dhe nuk vendos asnjë person vetëm", është shprehur Kurteshi. Ai ka thënë se Lëvizja

Vetëvendosje heziton t'i thërrasë tryeza të cilat nuk kanë efekt. Sipas Kurteshit, tryezat që janë mbajtur deri më tani, të organizuara fillimisht nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), më pas edhe nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kanë qenë shterpe. "Do të shohim nëse do ta thërrasim tryezën sepse ato tryeza që janë mbajtur deri më tash nuk kemi

parë se kanë prodhuar ndonjë efekt në drejtim të mobilizimit për angazhim për zgjidhjen e këtyre problemeve madhore. Tryezat e organizuara gjerë më tani nuk kanë prodhuar çështje të rëndësishme për vendin, prandaj edhe nuk ka kuptim të mbahen", ka theksuar ai. Kurteshi ka arsyetuar mospjesëmarrjen e Vetëvendosjes në tryezën e organizuar nga PDK-ja



odhuar asgjë të re

susi nuk mund të arrihet kur dikush vjen me receta të gatshme dhe thotë merre ose leje. Nuk jemi të interesuar të jemi pjesë e tryezave në të cilat flitet për çështje të cilat konsiderohen fakte të kryera, siç ishte platforma, caktimi i personit që do të jetë udhëheqës i bisedimeve e kështu me radhë", ka deklaruar Kurteshi. Megjithatë, ai ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje nuk do të jetë kundër tryezave të vërteta në të cilat do të merren vendime të rëndësishme dhe të drejta për vendin. Sipas Kurteshit, mbajtja e tryezave politike do të kishte kuptim vetëm nëse ato kanë për qëllim arritjen e një pajtueshmërie për t'u qasur të gjithë njësojë problemeve të mëdha kombëtare. "Ne jemi për këtë formë të tryezave. Rëndësi do të kishte mbajtja e tryezave vetëm nëse në to do të diskutohet për çështje me rëndësi për vendin dhe aty të gjithë do të mobilizohemi për zgjidhje të drejta, dhe jo kush po pozicionohet dhe ku po pozicionohet. Personalisht jam për mbajtjen e tryezave nëse ato prodhojnë konsensus, ku merren vendime të drejta për zgjidhjen e problemeve të vendit. Nëse tryeza organizohet vetëm sa për t'u treguar të tjerëve se çfarë platforma propozojnë, atëherë ato janë vetëm humbje kohe. Nëse tryezat bëhen për të arritur një pajtueshmëri për t'u qasur të gjithë njësojë problemeve të mëdha kombëtare atëherë mendoj se kanë kuptim të organizohen", ka thënë Kurteshi.

Tryeza e fundit e partive politike është organizuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Në të, përpos Lëvizjes Vetëvendosje dhe Listës Serbe, ishin të pranishme të gjitha partitë politike. Pavarësisht prej mungesës së këtyre dy subjekteve, drejtuesit e partive të tjera pjesëmarrëse kanë shprehur optimizëm për arritjen e konsensusit kombëtar për tema të mëdha. Përveç debatit për temat që konsiderohen të rëndësishë kombëtare, në tryezën e fundit përfaqësuesit e partive politike janë pajtuar të ketë një grup pune të përbërë nga shefat e grupeve të partive parlamentare dhe një përfaqësuesi të partive joparlamentare, i cili do ta caktojë temën konkrete për të cilën do të diskutohet në tryezën e radhës.

Mikpritësi i takimit, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se tani është bërë hapi i parë i institucionalizimit të tryezës së partive politike. Ai ka treguar se të gjithë pjesëmarrësit e kësaj tryeze kanë treguar gatishmëri për arritjen e konsensusit kombëtar.

duke thënë se ka qenë humbje kohe, meqë organizatorët i kanë pasur recetat e gatshme. "Ka kaluar një kohë prej asaj dite dhe nuk e di nëse ka kuptim që të kthehem mbrapa. Tryezat na janë dukur shterpe, sepse nuk kanë prodhuar asgjë të re. Thirrja e tryezave vetëm sa për të humbur kohë nuk kanë kuptim. Tryezat duhet të mbahen për të arritur një konsensus, e konsen-

Kosova synon të aplikojë për anëtarësim në Këshillin e Evropës

PRISHTINË, 13 MAJ - Nuk do të jetë e largët dita kur Kosova do të aplikojë për anëtarësim në Këshillin e Evropës, thonë përfaqësuesit politikë në Prishtinë. Përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës kanë bërë me dije se gjatë këtij viti Kosova pritet të aplikojë për anëtarësim në këtë mekanizëm.

Zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, ka thënë për "REL"-in se aktualisht po punohet intensivisht në planin e veprimit për anëtarësim në Këshillin e Evropës. "Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës ka krijuar grupin profesional për këtë proces. Ky grup që ka funksionuar nën menaxhimin e ministrit ka hartuar një strategji dhe plan veprimi për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Ky plan veprimi do të fillojë të zbatohet pas ndërtimit të konsensusit politik për këtë çështje që, në fakt, është edhe faza e parë e këtij procesi", ka thënë Vuniqi.

Këshilli i Evropës është një prej organizatave më të rëndësishme në Evropë dhe Kosova është i vetmi vend nga rajoni që nuk është pjesë e tij. Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i delegacionit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ka thënë për "REL"-in se kërkesa për anëtarësim në këtë mekanizëm duhet të bëhet por, siç ka thënë ai, para se kjo të ndodhë duhet të ketë siguri se mekanizmat përkatës do ta

përkrahin kërkesën për anëtarësim të Kosovës. "Qeveria është deklaruar disa herë, në veçanti ish-ministri i Jashtëm Enver Hoxhaj, duke përfshirë edhe presidentin e Kosovës, se ne do to të anëtarësohemi këtë vit apo atë vit, por përgjigja e mekanizmave të cilët merren me Kosovën në KE ka qenë negative, duke thënë se ende nuk janë pjekur kushtet dhe nuk ka siguri, duke pasur parasysh mënyrën se si merren vendimet në Këshillin e Evropës, që një kërkesë e tillë mund të kalojë dhe mund të futet në rend të ditës", ka thënë Haliti.

Megjithatë, sipas Halitit, pritet që Qeveria ta bëjë kërkesën sipas rregullave dhe proceduarve të organeve të cilat do ta trajtojnë kërkesën e Kosovës. "Deri tash ne kemi pasur përgjigje negative - neutrale, kështu do të thosha, duke na thënë se ende nuk janë plotësuar kushtet dhe kërkesa juaj mund të mos shqyrtohet", ka deklaruar Haliti.

Procesi i anëtarësimit në këtë mekanizëm është më shumë teknik dhe kërkon shumë reforma, sidomos në fushat e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut.

Deputetja nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Doruntinë Maloku-Kastrati, e cila është edhe anëtare e Komisionit për Punë të Jashtme, ka pohuar se Kosova më së largu deri në muajin gusht të këtij viti duhet të aplikojë për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Ajo ka thënë se ky aplikim duhet të ndodhë në këtë kohë, në

mënyrë që kërkesa të merret në konsideratë nga ministrat e vendeve anëtare të KE-së. Maloku-Kastrati ka theksuar se Kosova, duke qenë i vetmi vend në rajon që ende nuk është pjesë e Këshillit të Evropës, qytetarët e saj humbin shumë në fushën e të drejtave të njeriut e në shumë aspekte të tjera që lidhen drejtpërdrejt me demokracinë dhe sundimin e ligjit. "Qeveria e Kosovës pati premtuar se aplikimi do të ndodhte në muajin dhjetor të vitit të kaluar ose në janarin e këtij viti. Kjo nuk ka ndodhur për arsye që ne deputetët e opozitës nuk i dimë, porse është thënë vazhdimisht në media se dosja për aplikim nuk ka qenë e gatshme. Hapat që ka ndërmarrë Qeveria për zhbërjen e Gjykatës Speciale, liria e pjesshme e medieve si dhe mungesa e sundimit të ligjit, janë sigurisht disa nga arsyet qenësore që ne nuk ishim të gatshëm për aplikim, sepse në këtë mënyrë, besoj, kemi tronditur besimin e shteteve mike, përkrahja e të cilave është qenësore për aplikim apo anëtarësim në secilin organizëm ndërkombëtar", ka deklaruar deputetja Maloku-Kastrati. Ajo ka theksuar se është e pakuptimtë që Kosova edhe 10 vjet pas pavarësisë ende nuk e ka dosjen e përfunduar për aplikim.

Ndërkaq njohësit e integriteteve evropiane kanë thënë se anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës ka pasur mundësi të bëhet shumë me herët pasi që, sipas tyre, votat shumicë nga shtetet anëtare të KE-së kanë qenë në anën e Kosovës.



Mjekët specialistë nuk preferojnë punësimin në spitalet rajonale

PRISHTINË, 13 MAJ - Spitalet rajonale të Kosovës kanë mungesë të kuadrove mjekësore. Megjithatë, në konkursin e fundit të shpallur nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ditë më parë, për pranimin e mjekëve specialistë, këta të fundit nuk kanë shprehur interesim për t'u punësuar.

Në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt ishin kërkuar dy kirurgë të përgjithshëm, por nuk ka shprehur interesim asnjë kandidat. Edhe në Spitalin e Mitrovicës nuk kishte të interesuar të aplikojnë për punësim të specialistit të neurologjisë, otorinolaringologjisë, sikurse që nuk kishte interesim edhe për specialistë për punësim në repartin infektiv të këtij spitali, aty ku edhe ka mungesë të mjekëve.

Në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës, ndonëse ishte kërkuar një specialist i otorinolaringologjisë dhe specialist i radiologjisë, as këtu nuk ka aplikuar asnjë.

Drejtori i Spitalit të Gjakovës, Ahmet Asllani, ka thënë për "Radion Evropë e Lirë" se mungesa e mjekëve specialistë të fushave të caktuara është shumë e madhe. Por, mjekët specialistë, siç thotë Asllani, duket se cak i kanë vendet e Bashkimit Evropian, për të kërkuar punë dhe kushte më të mira. Ai ka theksuar faktin se edhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës

mbetet si një ndër vendet ku mjekët specialistë dëshirojnë të punësohen. "Kemi deficit në disa reparte, për shembull në Oftalmologji, ku është vetëm një mjeke 62-vjeçare. Kemi hapur konkurs për oftalmolog për ORL dhe të rengenologjisë. Ende është i hapur konkursi dhe asnjë kandidat nuk ka konkurruar", ka thënë Asllani, duke shtuar se në repartin e ORL-së janë dy mjekë. "Njëri është mbi moshën 63-vjeçare. Mendoj se çdo repart duhet t'i ketë nga pesë mjekë specialistë dhe të punohet me kujdestari pasi aty japim shërbime për shumë pacientë jo vetëm për Gjakovën, por edhe gjithë rrethinën. Siç duket, gjeneratat e reja po ikin jashtë Kosovës, madje po kanë më shumë dëshirë të punojnë në QKUK", ka thënë Asllani.

Ndërsa Shpend Fazliu, zyrtar për informim në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ka thënë se në konkursin publik të shpallur nga ky institucion për vende të lira pune, janë paraparë 22 profile të ndryshme mjekësore, ku janë kërkuar 28 specialistë në kuadër të spitaleve të përgjithshme. Por, siç thotë ai, interesimi i mjekëve ka qenë i pamjaftueshëm, edhe pse ekzistojnë vendet e lira të punës të aprovuara në buxhetin e vitit 2018. "Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ka shpallur konkurs për pranimin e special-



istëve, por nuk ka pasur interesim për spitalet regjionale çuditërisht. Ne si shërbim spitalor ftojmë të gjithë specialistët që janë të papunë, të aplikojnë dhe t'i plotësojnë vendet e punës për të cilat ka edhe buxhet për vitin 2018 dhe t'u ndihmojnë qytetarëve të atyre regjioneve", ka thënë Fazliu.

Drejtori i Spitalit të Përgjithshëm të Mitrovicës, Hamëz Berisha, i ka thënë "Radios Evropë e Lirë" se, ndonëse kanë nevojë për mjekë specialistë të lëmenjve të caktuar, dhe konkursi ishte shpallur nga

ana e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar, as në spitalin që ai udhëheq nuk ka pasur mjekë specialistë të interesuar për punë. "Konkursi është shpallur për nevojat që ne i kemi për repartin e Pulmologjisë dhe atë të Neurologjisë si dhe të Infektives. Por, nuk ka pasur konkurrentë. Kohë më parë kemi pranuar specialistë dhe tashmë janë funksionalizuar shumë reparte, por që Infektiva, Pulmologjia dhe Neurologjia kanë mbetur pa mjekë të mjaftueshëm. Për ata specialistë që kanë qenë të

papunë dhe ne kemi pasur nevojë, kemi shpallur konkurs dhe i kemi pranuar ata mjekë", ka thënë Berisha, duke shtuar se tri repartet kanë nevojë për nga tre mjekë specialistë.

Sidoqoftë, Ligji i Punës nuk i obligon mjekët specialistë të punojnë aty ku ka mungesë, por e lë mundësinë e zgjedhjes se ku ata dëshirojnë dhe mund të punësohen. Ky ligj nuk lejon që një mjek që ka kontratë pune me një institucion publik shëndetësor të aplikojë edhe në ndonjë spital regjional.

Zëvendësministri sot i raportojnë kryeministrit Haradinaj

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Zëvendësministri e Kosovës sot (e hënë) do të raportojnë para kryeministrit Ramush Haradinaj për punën e tyre në kuadër të ministrive përkatëse. "Kryeministri Ramush Haradinaj në orën 7:00 pret në takim pune zëvendësministri në Qeverinë e Kosovës", është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Më herët, Zyra e Kryeministrit është shprehur e kënaqur me punën që deri më tani kanë bërë zëvendësministri, numri i të cilëve arrin në 80 sish.

Në bazë të raporteve të punës që i kanë dorëzuar në zyrën e kryeministrit, Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shihet se zëvendësministri kanë pasur angazhime serioze. "Prej punës që ata kanë prezantuar në raportet e tyre tregojnë se kanë pasur angazhim serioz.

Ka ministri që zëvendësministri kanë pasur punë shumë konkrete, aty ku janë koordinatorë të temave të caktuara dhe udhëheqës të projekteve të caktuara", ka thënë Tahiri, duke u shprehur i kënaqur me punën që ata kanë bërë deri më tani. "Nga ajo çfarë kam parë në raporte, jam i kënaqur me punën e zëvendësministrave, por ky është vetëm një vlerësim personal, sepse vlerësimin për punën e tyre duhet ta japin ministri dhe kryeministri", është shprehur ai.

Edhe zëvendësministri të cilët janë kontaktuar nga gazeta kanë mbrojtur punën e tyre gjatë kësaj periudhe kohore të qeverisjes.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme që vjen nga radhët e PDK-së, Izmi Zeka, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se raporti i punës së tij është fokusuar në tri drejtime: takime me miqtë ndërkombëtarë,



angazhim në strategjinë për migrim, riatdhesim dhe armë, si dhe në politikëbërjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Edhe zëvendësministri i AKR-së

në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ka punuar më shumë se kolegët zëvendësmin-

istra në këtë ministri. Por, njohtësit e rrethanave politike mendojnë se zëvendësministri me punën e tyre nuk i arsyetojnë as pagat që marrin.

Pacolli mbështet idenë e krijimit të zonës ekonomike amerikane

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se e mbështet fuqishëm idenë e krijimit të zonës ekonomike amerikane, e cila do t'i tërheqë kompanitë amerikane për të ardhur në Kosovë

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 13 MAJ - Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, është zotuar se do ta shtyjë përpara idenë për krijimin e zonës së veçantë ekonomike për amerikanët. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ka shumë kompani amerikane që janë të interesuara të investojnë në Kosovë. "Mbështes fuqishëm idenë e lansuar për krijimin e zonave ekonomike, me theks të veçantë një zonë për investitorët amerikanë në Kosovë, e cila do të ishte shtyllë e shtuar e marrëdhënieve strategjike midis Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara dhe do

t'i tërheqë kompanitë amerikane për të ardhur në Kosovë", ka deklaruar Pacolli. Ai ka shtuar se për një kohë të gjatë ka promovuar idenë e zonave ekonomike në Kosovë që, sipas tij, do të tërheqin më shumë investime të huaja, do të sjellin kapital të huaj dhe ekspertizë në Kosovë, si dhe do të krijojnë vende të reja pune për rininë, duke u dhënë atyre një të ardhme më të ndritur. "Në mandatin qeverisës 2011/2014 arritëm ta bëjmë përgatitjen ligjore, por më vonë nuk u bë asgjë", ka thënë Pacolli.

Zëvendëskryeministri Pacolli ka pohuar se ka shumë kompani amerikane në Kosovë dhe shumë më tepër mund të vijnë nëse krijojnë kushte që do ta bënë Kosovën më tërheqëse



në rajon dhe në Evropën Lindore. "Unë do ta shtyj në qeveri këtë ide që së shpejti ta marrim vendimin për të krijuar një zonë ekonomike për investitorët amerikanë dhe për

të organizuar një forum ekonomik-investimesh midis Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara që do ta bashkonte komunitetin e biznesit të dy vendeve tona. Besoj se do të

kemi rezultate konkrete duke sjellë më shumë investime, duke krijuar më shumë vende pune dhe duke pasur një të ardhme më të mirë për vendin tonë", ka thënë Pacolli.

Mbi 15 000 të rinj përkrahin vlerat e PDK-së

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka njoftuar se që nga fillimi i procesit zgjedhor të Rinisë Demokratike janë mbajtur mbi 570 takime zgjedhore në nivel seksionesh, nëndegësh dhe degësh. Në këtë proces bëhet me dije se kanë qenë të angazhuar me pjesëmarrje, votim dhe procese të tjera brenda Rinisë Demokratike mbi 15 000 të rinj, të cilët mbështesin vizionin e Dekadës së Re

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 MAJ - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e ka vlerësuar të suksesshëm procesin e deritashëm zgjedhor brenda Rinisë Demokratike. Kjo parti ka bërë me dije se deri më tani, në kuadër të procesit zgjedhor të Rinisë Demokratike, janë mbajtur 570 takime zgjedhore. "Zgjedhjet e brendshme të Rinisë Demokratike kanë vënë në veprim grupet punuese të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), duke përcjellë punën e kuvendeve zgjedhore, anekënd vendit, me tubime dhe debate të brendshme rreth këtij procesi të rëndësishëm partiak. Nga fillimi i këtij aktiviteti të rëndësishëm për zgjedhjen e organeve të reja të Rinisë Demokratike janë mbajtur mbi 570 takime zgjedhore në nivel seksionesh, nëndegësh dhe degësh", është thënë në komunikatën e PDK-së. Sipas PDK-

së, këto angazhime në të gjitha nivelet e Rinisë Demokratike kanë dëshmuar dhe rikonfirmuar vitalitetin, përkushtimin dhe organizimin e mirëfilltë të rinisë dhe strukturave të tjera për vlerat e mirëfillta të PDK-së, në Dekadën e Re. "Në këtë drejtim deri më tani kanë qenë të angazhuar me pjesëmarrje, votim dhe procese të tjera brenda Rinisë Demokratike mbi 15 000 të rinj, të cilët mbështesin, përkrahin dhe zotohen për promovimin e vlerave të Partisë Demokratike dhe vizionit të saj, Dekada e Re", është theksuar në këtë komunikatë.

Kjo parti ka vlerësuar se të rinjtë e PDK-së janë garancia e fuqizimit të proceseve shtetformuese. "Të rinjtë që përcjellin vazhdimësinë e vlerave më të mira dhe më shembullore të Partisë Demokratike të Kosovës dhe organeve legjitime që dalin nga procesi demokratik zgjedhor brenda Rinisë Demokratike janë garancë e fuqizimit të organeve të partisë shtetfor-



muese, shtetndërtuese, me vizion të qartë me besim, zhvillim dhe integritet. Me këtë proces të brendshëm demokratik, të rinjtë kanë përzgjedhur dhe vijojnë këtë proces zgjedhor, duke çuar përpara këto vlera të tyre, brenda PDK-së, si forcë e jashtëzakonshme politike, duke dhënë përgjigje dhe dalë përball dhe ofruar zgjidhje për sfida të rinjve dhe vendit, në Dekadën e Re", është thënë në

komunikatën e PDK-së.

Sipas PDK-së, procesi zgjedhor brenda Rinisë Demokratike, si asnjëherë më parë, ka mbledhur dhe po tubon të rinjtë më të devotshëm në çdo cep të Kosovës, duke u zgjedhur dhe duke u bërë kandidatë për t'u zgjedhur brenda strukturave me bindjen e thellë se Dekada e Re promovon besim, zhvillim dhe integritet. "Dekada e Re është rruga e së ardhmes për ta

dhe vendin tonë, Republikën e Kosovës. Procesi i brendshëm zgjedhor, i nivelit lokal i Rinisë Demokratike, do të përmbyllet me Konventën zgjedhore të Rinisë Demokratike të Kosovës, duke fuqizuar rininë në marrjen e përgjegjësi, përfaqësim dhe si pjesë e procesit, vlerave dhe vizionit të Dekadës së re, të Partisë Demokratike të Kosovës", është thënë në komunikatën e PDK-së.

Flet për "Epokën e re" guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti

Pritet të ketë ulje të



- SEKTORI BANKAR NË KOSOVË VAZHDON TË JETË STABIL

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se duke marrë parasysh trendin e vazhdueshëm të uljes së normave të interesit dhe konkurrencën gjithnjë në rritje të sektorit bankar, vlerëson se bankat do të vazhdojnë të reflektojnë për uljen e normave të interesit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mehmeti ka theksuar se normat ekzistuese janë përgjithësisht të njëjta me ato të vendeve të tjera. Ai ka thënë se sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë stabil. Guvernatori Mehmeti ka thënë se të gjitha bankat janë likuide, stabile dhe kanë burime të mjaftueshme të financimit të aseteve. Ai ka treguar se në periudhën janar - prill të këtij viti Divizioni i Ankesave ka pranuar gjithsej 146 ankesa kundër bankave komerciale

**EPOKA
ERE****Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 MAJ - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka bërë me dije se sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë stabil. Ai ka thënë se ky stabilitet bankar vjen në sajë të mbikëqyrjes së përafërt dhe proaktive të bankave nga Banka Qendrore e Kosovës.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", guvernatori Mehmeti ka thënë se të gjitha bankat janë likuide, stabile dhe kanë burime të mjaftueshme të financimit të aseteve.

Mehmeti ka theksuar se duke marrë parasysh trendin e vazhdueshëm të uljes së normave të interesit dhe konkurrencën gjithnjë në rritje të sektorit bankar, vlerëson se bankat do të

vazhdojnë të reflektojnë për uljen e më tutjeshme të normave të interesit. Ai ka shtuar se shuma e depozitave në prill të këtij viti është 3.09 miliardë euro dhe paraqet një rritje vjetore të depozitave prej 4.8 përqindësh. Mehmeti ka bërë me dije se në periudhën janar - prill të këtij viti, Divizioni i Ankesave ka pranuar gjithsej 146 ankesa kundër bankave komerciale. Ai ka treguar se ankesat më të shpeshta kanë të bëjnë me çështje të ndryshme që ndërlidhen me kredi, si dhe çështje që ndërlidhen me llogari.

"Epoka e re": Z. Mehmeti, disa herë është potencuar se sistemi financiar në Kosovë është stabil. Cilët faktorë ndikuan në këtë stabilitet?

Mehmeti: Sektori bankar vazhdon të jetë stabil në sajë të

normave të interesit



mbikëqyrjes së përafërt dhe proaktive të bankave nga BQK-ja, e cila përcillet me anë të ekzaminimeve në vend dhe nga jashtë të bankave, si dhe menaxhimit të mirë të rreziqeve bankare nga bankat. Stabiliteti i sektorit bankar evidentohet edhe me anë të treguesve të shëndetshmërisë të cilat monitorohen në vazhdimësi nga BQK-ja. Treguesit kyçë të cilët evidentojnë qëndrueshmëri të sektorit bankar me gjendje preliminare të prillit 2018-s, ka rritje (vjetore) në gjithë treguesit siç janë: asete prej 5.8 përqindësh, kredi 10.4 për qind, rritje të depozitave 4.8 për qind dhe përmirësim të dukshëm të kredive joperformuese në 2.9 për qind e cila ka shënuar zvogëlim të dukshëm në krahasim me vitin paraprak prej 4.3 përqindësh.

"Epoka e re": Sipas raportit të fundit të BQK-së, vërehet rënie drastike e normave të interesit në depozita krahasuar me vitet para 2014-s. Aktualisht si sillen normat e interesit për depozita të individëve dhe bizneseve?
Mehmeti: Normat e interesit në depozita në mars të këtij viti evidentojnë rritje në krahasim me vitet paraprake. Norma e interesit në depozita me gjendje të marsit 2018 është 1.18 për qind krahasuar me 0.96 për qind sa ishte në mars të 2017-s, e përcjellë me normë të interesit për biznese prej 1.44 përqindësh dhe për ekonomitë familjare prej 1.10 përqindësh. Të gjithë bankat janë likuide, stabile dhe kanë burime të mjaftueshme të financimit të aseteve.

"Epoka e re": Çfarë shume të depozitave kemi në TM1 të këtij viti dhe si është raporti me vitin paraprak?
Mehmeti: Shuma e depozitave në prill të këtij viti është 3.09 miliardë euro, e cila paraqet një rritje vjetore të depozitave prej 4.8 përqindësh.

"Epoka e re": Po norma mesatare e interesit në kredi si sillet, dhe mbi çfarë baze disa banka punëtorëve të sektorit privat u japin kredi me normë më të lartë të interesit?
Mehmeti: Në fushën e normave të interesit ka zhvillime shumë pozitive që janë reflektuar me uljen e dukshme të normave të interesit. Bazuar në të dhënat për muajin mars 2018, norma efektive e interesit është 6.8 për qind, që përfshin bizneset dhe ekonomitë familjare, përderisa norma e interesit vetëm për biznese është 6.60 për qind. Në raste të caktuara për kreditë hipotekare, norma e interesit varion nga 4 për qind deri 6 për qind. Marrë parasysh trendin e vazhdueshëm të uljes së normave të interesit si dhe konkurrencën gjithnjë në rritje të sektorit bankar, vlerësojmë se bankat do të vazhdojnë të reflektojnë në uljen e më tutjeshme të normave të interesit, edhe pse, siç është cekur, tani normat ekzistuese janë përgjithësisht të njëjta me ato të vendeve të tjera. Procesi i kreditimit të bankave bazohet në strategjinë, politikat dhe procedurat kreditore të saj të cilat janë të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve të Bankës. Në kuadër të këtyre dokumenteve janë të specifikuara kushtet dhe kriteret

e kreditimit. Kriter kryesor me rastin e përcaktimit të normës së interesit merret rrezikshmëria e kredisë.

"Epoka e re": Sa është numri i ankesave të konsumatorëve ndaj bankave? Të çfarë natyre janë ankesat?
Mehmeti: Në periudhën janar - prill të këtij viti Divizioni i Ankesave ka pranuar gjithsej 146 ankesa kundër bankave komerciale. Ankesat më të shpeshta kanë të bëjnë me çështje të ndryshme që ndërlidhen me kredi (si, p. sh., kategorizimi në regjistrin e kredive, parapagimi i kredive etj.) si dhe çështje që ndërlidhen me llogari (si, p. sh., bllokimi i llogarisë). BQK-ja bën ekzaminime të rregullta tek institucionet financiare dhe në rast të shkeljeve të vërejtura apo të raportuara, konform legjislacionit në fuqi dhe kompetencave që ka, merr masa të mëtejshme.

"Epoka e re": Z. Mehmeti, Banka Kombëtare Tregtare në Kosovë ua mbylli xhirollogaritë punëtorëve të Kolegjit "Mehmet Akif". Mbi bazën e cilit vendim ka mundur të bëhet mbyllja e xhirollogarive?
Mehmeti: Çështja e marrëdhënieve bankë - klientë, në këtë rast të llogarive bankare, definohet në Ligjin për Marrëdhënie Detyrimore. Ne si BQK konform kompetencave ligjore që kemi dhe bazuar në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë kemi ndërmarrë hapat në këtë drejtim përmes ekzaminimit të kësaj banke lidhur me çështjen në fjalë.

"Epoka e re": Në Komisionin për Buxhet dhe Financa u vendos të formohet një grup punues sa iu përket institucioneve mikrofinanciare të cilat veprojnë si OJQ. Sa e kanë destabilizuar sektorin financiar këto OJQ?
Mehmeti: Institucionet mikrofinanciare OJQ, ngjashëm si institucionet e tjera financiare, janë subjekt i mbikëqyrjes së rregullt nga BQK-ja dhe, si rrjedhojë e proaktivitetit të BQK-së, institucionet e tilla kanë rezultuar t'i ngrehin kapacitet e tyre qeverisëse duke ndikuar kështu edhe në stabilitetin e sektorit financiar.

"Epoka e re": Çarë masash do të merrni kundër tyre dhe a do të ketë përfaqësues të BQK-së në këtë grup?
Mehmeti: BQK-ja ka vepruar dhe do të veprojë gjithnjë në raport me këto institucione brenda mandatit për të cilin janë regjistruar nga BQK-ja, përderisa çështjet të cilat lidhen me statusin e tyre, duke qenë në kompetencën e Zyrës së OJQ-ve, pranë Ministrisë së Administratës Publike, siç edhe kemi potencuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, vlerësojmë se duhet adresuar me Ligjin për Lirinë e Asocimit të Organizatave Joqeveritare. Sa i përket grupit punues lidhur me adresimin e çështjeve të cilat ndërlidhen me institucionet mikrofinanciare OJQ, BQK-ja do të mbetet përkrahëse për formimin e këtij grupi pune dhe, e gatshme të ketë edhe përfaqësues aktiv në grup pune nëse do të kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Reshitaj premtion ndërprerjen e lejeve të reja për hidrocentralet në Kosovë

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Më 11 maj të këtij viti ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, u takua me përfaqësues nga Environmentally Responsible Action (ERA) Group, drejtori ekzekutiv Fatos Lajçi dhe drejtoresha e programeve Ellen Frank-Lajqi, për të diskutuar për situatën rreth zhvillimit të hidrocentraleve në Kosovë. ERA u bashkua në takim nga partneri i tyre i ngushtë FIQ, i përfaqësuar nga drejtoresha ekzekutive Dajana Berisha, si dhe anëtarë të kabinetit të ministrit dhe përfaqësues nga uji,

inspektimi, planifikimi hapësinor dhe mjedisi. Gjatë takimit ministrja Reshitaj ka shprehur shqetësimin për gjendjen aktuale të ujit të Kosovës, përfshirë gjendjen e lumit Lumëbardhi i Deçanit pas ndërtimit të hidrocentraleve të reja dhe pakënaqësinë që hulumtimi i fundit mbi burimet e ujit të freskët të Kosovës (sipër dhe poshtë) u krye në vitin 1984. Si rezultat, ministrja Reshitaj ka premtuar t'i ndërpresë të gjitha lejet e reja të hidrocentraleve në Kosovë derisa të përfundojë një studim i ri mbi burimet ujore të Kosovës që matë ujin sipër dhe

nën tokë. Po ashtu, ajo ka formuar një komision që do t'i rishikojë të gjitha lejet e mëparshme që janë dhënë për hidrocentralet, si dhe është duke punuar drejt një administrate më efikase. Kohët e fundit ERA group së bashku me organizata të tjera lokale nga Peja i mobilizuan komunitetet në Deçan, veçanërisht Lloqan, për të ushtruar presion ndaj Qeverisë për ta ndalur zhvillimin e një hidrocentrali të ri në Grykë të Lloqanit. Si rezultat i kësaj, ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka



refuzuar ta pranojë vlerësimin e ndikimit në mjedis për projektin dhe anuloi pëlqimin mjedisor, duke premtuar se asnjë

hidrocentral i ri nuk do të ndërtohet brenda parqeve kombëtare siç parashihet edhe sipas ligjit.

Përkujtohen Nebih dhe Tahir Meha në 37-vjetorin e rënies heroike

Pushkët e Tahir dhe Nebih Mehës ishin zgjim kombëtar

"Qëndresa heroike e Nebih dhe Tahir Mehës do të kujtohet gjithmonë. Vetëdija historike, duke kujtuar dhe nderuar përherë heroizmin e vajzave dhe djemve tanë, ishte udhërrëfyese e pagabueshme për realizimin e synimeve shekullore, lirisë dhe pavarësisë", kështu ka thënë presidenti i vendit, Hashim Thaçi, me rastin e 37-vjetorit të rënies heroike të Nebih e Tahir Mehës

"Epoka e re"

SKENDERAJ, 13 MAJ - Për nder të 37-vjetorit të rënies heroike të Nebih e Tahir Mehës, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku, kryesuesen e Kuvendit Komunal, Fatbardha Haliti, si dhe me kryetarin e Drenasit, deputetë, asamblistë, familjarë dhe qytetarë, kanë bërë nderime dhe vendosur buqeta me lule pranë varrezave të Nebih e Tahir Mehës. Pas homazheve është mbajtur një manifestim përkujtimor te kulla e Tahir Mehës.

Të pranishmëve me një fjalë rasti u është drejtuar kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ai i Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe Ilir Meha në emër të familjes Meha.

Ndërkaq presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se rezistenca e armatosur e Nebih dhe Tahir Mehës në Prekaz kundër regjimit serb, pas demonstratave gjithëpopullore që kishin nisur anembanë Kosovës në vitet e '80-ta, hapi një kapitull të ri. Presidenti përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka theksuar se sot u bënë 37 vjet nga rënia e tyre, në mbrojtje të familjes dhe kauzës shqiptare.



"Qëndresa heroike e Nebih dhe Tahir Mehës do të kujtohet gjithmonë. Vetëdija historike, duke kujtuar dhe nderuar përherë heroizmin e vajzave dhe djemve tanë, ishte udhërrëfyese e pagabueshme për realizimin e synimeve shekullore, lirisë dhe pavarësisë", ka shkruar Thaçi. Rezistencën e Nebih dhe Tahir Mehës në Prekaz e ka kujtuar edhe kryetari i Kuvendit të

Kosovës, Kadri Veseli, i cili ka thënë se pranvera e vitit 1981 ishte pranvera e zgjimit kombëtar në Kosovë. "Pjesë e këtij zgjimi ishin edhe pushkët e Tahir dhe Nebih Mehës në Prekaz. Rezistenca e tyre njëditore kundër njësive speciale të policisë jugosllave ringjalli modelin tradicional të luftës për liri dhe kështu u bë shembull për gjeneratat e ardhshme që përm-

bushën misionin e çlirimit përfundimtar të Kosovës", ka deklaruar Veseli.

Ndërkaq zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se Tahiri e Nebihu ranë heroikisht 37 vjet më parë në kullën e tyre pasi nuk pranuan t'u dorëzoheshin forcave policore dhe ushtarake serbe. "Kosova sot i përkujton dy nga veprimtarët e hershëm të çështjes kombëtare, Tahir e Nebih Mehën. Tahiri e Nebihu ranë heroikisht 37 vjet më parë në kullën e tyre pasi nuk pranuan t'u dorëzoheshin forcave policore e ushtarake serbe. Sakrifika dhe rezistenca e tyre erdhi vetëm pak muaj pas protestave të studentëve, të organizuara asokohe. Liria e Kosovës është arritur me mundin, sakrificën dhe gjakun e shumë brezave. Kosova do t'i nderojë dhe do t'u jetë përjetë mirënjohëse të gjithë atyre që e bënë të mundur lirinë e Kosovës. Lavdi veprës së Tahirut e Nebihut! Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!", ka thënë Limaj.

Drenasi shpall qytetar nderi zëvendëspresidentin e PE-së

DRENAS, 13 MAJ (ER) - Komuna e Drenasit edhe zyrtarisht të shtunën, në një ceremoni të organizuar, i ka dorëzuar titullin "Qytetar Nderi i Komunës", zëvendëspresidentit të Parlamentit Evropian, Rainer Wieland.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i shoqëruar nga

kryeministri Ramush Haradinaj, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe stafi i tij, kanë pritur zëvendëspresidentin Wieland në zyrë, ku Lladrovci ka njoftuar për punën dhe projektet e Komunës së Drenasit.

Pastaj në seancën e Kuvendit të Komunës, ku ishin të pranishëm asamblistë të Kuvendit, përfaqë-

sues të subjekteve politike, fetare, kulturore e diplomatike, edhe zyrtarisht i është dorëzuar Wielandit çmimi "Qytetar Nderi i Komunës". Seancën solemne e ka hapur kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit, Labinot Halilaj, i cili edhe ka paraqitur një historik të shkurtër të veprimtarisë së Wielandit.



Sot mbahet akademi përkujtimore për Bahri Fazliun dhe Agron Rrahmanin

PRISHTINË, 13 MAJ - Me rastin e 20-vjetorit të rënies së heronjve Bahri Fazliu dhe Agron Rrahmani sot (e hënë) në orën 12:00, në Kinemanë "ABC" në Prishtinë, do të mbahet akademi përkujtimore kushtuar këtyre dy heronjve. Me këtë rast do të shfaqet edhe film dokumentar kushtuar Bahriut dhe Agronit, nën regji të Kushtrim Sheremetit.

Etem Arifi rizgjedhet kryetar i Partisë së Ashkalinjve për Integrim

Prishtinë, 13 maj - Partia e Ashkalinjve për Integrim të dielën ka mbajtur Kuvendin e

Tretë Zgjedhor në të cilin ka zgjedhur organet e reja drejtuese. Etem Arifi është rizg-


jedhur kryetar i Partisë së Ashkalinjve për Integrim. Të pranishëm në këtë kuvend të

kësaj partie ishin 176 anëtarë. Arifi mori 173 vota për kryetar partie dhe tri vota kundër.



Nga shkolla kombëtare e Prekazit për progres kombëtar deri në liri, vlera historike dhe filozofike-kombëtare e luftës së UÇK-së 1991-1999 nuk bën të nëpërkëmbet (23)

Si po hulumtohet logjika e shkollës shtetërore globaliste në shembullin e UÇK-së



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Sot luftën e UÇK-së janë kah e studiojnë edhe hulumtojnë disa shkolla globaliste, të cilat me egoizëm të paparë e përcjellin fuqinë e saj si në ide, po ashtu edhe në praktikë në optikën neokoloniale: si doli, kah u organizua dhe si ngadhënjë, pa fabrika ushtarake, pa banka, pa klinika shëndetësore, pa e pasur shtetin prapa, por duke e pasur një komb të tërë përkrah, por jo "shtetin" legalisht, sepse e kishte të ndaluar ose e pengonte luftën tërthorazi. Prandaj, duke iu frikuar modelit, institucionit historik dhe politik, UÇK-në kjo shkollë po tenton që institucionin e neoluftës ta përplasë në çdo shkëmb, sepse çdo krijesë e re kuptohet se ka pengesa. Po e bën këtë sepse ai "shkëmb" e ka mërinë antipodë të shkollës për të drejta të njeriut dhe neokolonializëm, madje në shkollë të të drejtave të shtetit, për t'i disiplinuar qytetarët e tij. Kjo shkollë me variantin e dhunës, si institucion që e kishte të kodifikuar ligjin e traditës së ndritshme të luftës për liri, në fillim e deri në mbarim të shekullit XX, me vitalitetin e saj, në fillim të shekullit XXI, prapë me një ritëm të përshpejtuar, ka filluar të marrë pozicion të bërjes së njëfarë lufte për "drejtësi sociale", po në atë stil siç e bëri pas vitit 1917, kur godina e saj shoqërore u mbulua me një "religjion" ndryshe, prej të cilit Ati e nxjerr shpirtin e shenjtë dhe "nëpërmjet Birit" e bekon në trupin e besimtarit, për ta ngritur tërë atë teatër në triumf

revolucionar. Kjo shkollë, gjithnjë në heshtje, duke peshuar tinëzisht në totalitarizëm fashisto-komunist, përmes pushtetit politik, ka nxjerrë njëfarë doktrine metafizike edhe sot, kinse sikurse në vitin 1935 dhe në thelbin e saj të përbashkët fashisto-komuniste, me idenë dhe materien e vet përbuzëse është duke e përbuzur çdo gjë që është pozitive jo vetëm në luftën e UÇK-së në Kosovë dhe kudo që është zhvilluar dhe zhvillohet lufta e drejtë. E vëreni fenomenin e akuzimit dhe dënimit të të gjithë komandantëve që e kanë drejtuar UÇK-në. Kjo politikë, jo sot aq tragjikisht, do të na hakmerret sepse fjalët e këtoditëshme, se një deputet, ish-komandant i Llapit që "duhet të shkojë në burg për ndonjë kërkesë që mos të bashkëpunohet me okupatorin, e gëzoi një diplomat fare hapur". Po vendi i tij shumë i nderuar, ka dënuar komandantë të tillë. Jo, kurrë, historinë e vendit të tij e njohim fare mirë, madje hollësisht. Mik po, por rri si mik, sepse për 13 000 shqiptarë të masakruar civilë, askush nga okupatori deri më sot nuk është dënuar.

Kjo shkollë me dy norma të drejtësisë, me program është duke e penguar çdo progres që shpie kah demokracia dhe kushtetutshmëria globale, për ta rrënuar kundërshtarin dhe filozofinë e tij. Tash, në këtë pozicion që ka mbetur në përgjithësi, kjo shkollë disi po përpiket të tregojë në shkallë primitive se nuk ka firmë "Lindore" as "Perëndimore", por denominohet si parim interesash dhe të drejtash historike-shtetërore, pra jo popullore. A nuk vihet pavarësia e Kosovës në dyshim me këto akuza të fabrikuara, sidomos në rastin e akuzës Dik Martinoviq, i cili nuk e ka bërë atë për mëshirë, por ka qenë i autor-

izuar dhe i paguar për ta bërë. Frika në miqësi ka filluar të shpalohet ngadalë por, sigurt. Kësaj politike nuk kemi si t'ia vëmë emrin ndryshe përpos që, ku ka qenë ish-shteti, qoftë edhe okupator të ketë të drejtë në "rizorgjimento". Madje, në shkallën më ekstreme, kjo shkollë ka nxënë të shprehet sidomos në Kosovë, aty ku lindi doktrina e thyerjes së filozofisë së "robit modern" të paleoluftës, të përljer me mentalitet të pacifizmit nobelist, madje duke moralizuar se "na kanë pranuar edhe njëfarë shteti fantazmë MZ"! Kjo shkollë në rrethanat e sotme disi ka krijuar kapital "malinj" dhe po vë gjithnjë duke u fshehur, por duke rrezikuar agresivisht, por si gjarpri më helmues po taktizon, po shkrepe poza pas mureve dhe fenomeneve "humane" të civilizimit, po karikon nëpër mure dhe vetë, pastaj po akuzon, gjithnjë duke promovuar njëfarë faraonizmi të situatës politike, në disa regjione kritike, duke treguar pasion injorant intelektual dhe, si i tillë, po mbetet relik i paarsimim. Çka është më keq, kjo shkollë luftën e UÇK-së edhe sot më fuqishëm se kurrë, përpiket të shndërrojë në gjak të derdhur kot, sepse e "drejta historike shtetërore" dhe fuqia e NATO-s është më e "vjetër", se e drejta e vetëvendosjes së popullit. Madje ajo e drejtë historike për të dhe mbi të, paska filluar më 1989 dhe paska mbaruar falë Zotit qysh në mesjetë. Hipokrizia e kësaj shkolle për shkak të mungesës së arsimit fillor, për shkak se ka deficit të fakteve historike në shumë skena, të cilat ju duket se ne nuk i vërejmë, vakuumin tonë mosveprues, ose partnerizues, siç është de jure, kjo nomenklaturë që punon tinëzisht për të drejtën e shtetit, filozofinë e vet humane po e shndërron në kërcënim me një

anë nga faktorët e brendshëm, por edhe në anekdota që lansohen nga faktorët e jashtëm, gjithnjë për përdorim të gjerë nëpër zyrrat diplomatike: Kjo shkollë diku-diku po klithë: "Po largohemi nga Kosova, sepse sot nuk i kemi 25 milionë dollarë, por po t'i kishim 250 milionë, do të ishin pak". Ky fakt do të thotë se këtë shkollë e ka mbështetur për muri varfëria e saj, por e ka bartur andej kah duhej vitaliteti dhe lufta e drejtë e një populli, i cili e lindi UÇK-në pa i pyetur fare institucionet shtetërore, të cilat ishin embrion për ta lënë popullin e UÇK-së invalid dhe në shans se do të mbijetojë, madje kur dihet se me mbi një milion ishin arratisur nga trojet 1998/1999.

E tërë ajo që u tha më lart, shkolle e së drejtës shtetërore i ka larguar prej këndeje tërë përkushtimi i një gjenerate, e cila nuk kishte fabrika ushtarake, nuk kishte banka, nuk kishte asnjë garanci ndërkombëtar, por UÇK-ja kishte popull dhe kishte territor. Prandaj tërë këtë përparësi historike, shqiptarët e Kosovës subjektet e neoluftës nuk do ta kthejnë në aferë politike, për të mbetur partner të paleoluftës. Por, afera politike deri më sot nuk ka pushuar nga çdo kënd i ish-regjimit që të pengojë çdo prosperitet, ta pengojë "trenin e historisë", duke i vënë gurë në binarë, duke i rrënuar edhe binarët në çdo rrugëtim.

Të shprehemi hapur, shkolla pansllaviste do të luftojë me çdo mjet për ta krijuar mundësinë e ndryshimit të një normativi shtetëror neofashist në Kosovë që ishte realitet deri më 1999. Por, në fund qëllimi është për të mbetur Kosova pjesë e regjimit dhe robërisë infibulacionale, gjithnjë për të mbetur kjo trevë etnike shqiptare, rregullore e mbyllur, e shkëputur dhe e normuar në robëri, edhe pse një

pjesë e "sovrانيتit" të saj do të grabitej nga ish-institucionalistët dhe pacifistët e teletisur në nobelizëm kriminal, sepse ata "forcohen kur vriten heronjtë, madje në vllugun e luftës inicijonë ndërprerje të luftës çlirimtare njëanshëm duke e favorizuar edhe dezertimin ushtarak, fakt ky që ka ngjarë". Së voni kjo shkollë e ka zgjeruar spektrin, se forcohet nëse burgosen heronjtë dhe prijësit e luftës çlirimtare. Dhe këto burgosje ngjajnë sepse drejtuesit nuk kanë qenë të vëmendshëm që luftën e tyre ta mbështesin në dokumente ndërkombëtare valide mbi ligjet e luftës së drejtë. Por, realiteti ka ngjarë sikur të ishin shumë dokumente të tilla, por shkrimet nuk janë. Të paktën kështu po na thuhet kur si historianë luftës së UÇK-së po i bëjmë njëfarë avokature, por jo politikë mesquine, sepse e kemi ballin lart, se kemi bërë luftë të drejtë dhe pikë.

Shumëçka nga ky realitet i përimituar sot na duket si tregim për një shoqëri të organizuar fare jo profesionalisht, e cila në fillim të dekadës së fundit të shekullit të kaluar i kishte zbuluar të gjitha letrat e pansllavizmit. Mu për këtë, Konferenca e Londrës më 1992, po mos të ishte realitet edhe atëherë ideja e saj, sot forcat e okupatorit do të kishin shans të krijonin rrethana të Londrës së vitit 1913. Prandaj, shtrojmë pyetjen kush i zbuloi rreshtimet kryqëzatë antishqiptare, përgjigjen do ta gjejmë në një shoqëri të përgjakur ish-jugosllave e ku plaga më e rëndë ishte moszgjidhja e çështjes shqiptare. Dhe çka u nevojiti që UÇK-ja për një dekadë të luftojë dhe të gjende mi ku jemi sot. Të gjithë studiuesit, duke u përgjigjur në këtë pyetje, sikur i japin përparësi faktorit të jashtëm, realitet ky që është imponuar nga LDK-ja që e sabotoi luftën e drejtë fillim e mbarim. Dhe m'u për këtë, sot kemi në Kosovë një shoqëri të përçarë që është rezultat i ndarjeve shumë të egra që ishin realitet kundër UÇK-së më 1992-1999, nga soji i shqiptarëve sehirxhi, me qëllime pacifiste. Madje edhe sot mund të gjenden politikanë që kanë pozita dhe kanë krijuar pasuri të dyshimtë, por lartësia e pasurisë tyre nuk "shihet", por është shpalosur një ofensivë shumë e egër, madje me ndihmën e disa evropianëve, që gati të gjithë komandantët e zonave operative të përgojohen, të burgosen dhe të luftohet me çdo kusht, që këta heronj, populli t'i urrejë sepse pas luftës paskan "grabitur çdo gjë". (Vijon)



**FTESË PËR TENDER**

Banka fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertat për:

PLOTËSIMIN E NEVOJAVE VJETORE TË BANKËS PËR FURNIZIM DHE SERVISIM TË KASAFORTAVE PËR DESTINIME TË NDRYSHME

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare.
- specifikacionet e kasafortave, katalogjet.
- dokumentacionin e nevojshëm mbi regjistrimin e biznesit dhe TVSH-në.
- referencat – kontratat mbi punë të ngjashme.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më 22 Maj 2018 në ora 15:00.

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku një muaj nga data e dorëzimit.

Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për furnizim/servisim të kasafortave" duhet të dorëzohen në recepcion në lokalet e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike, Sh.A. Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në cdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nëna Terezë p.n
10000 Prishtinë, Kosovë

info@bekonomike.com
Tel. +383 (0) 38 500 500
Fax. +383 (0) 38 500 507

**FTESË PËR TENDER**

Banka Ekonomike Sh.A. Prishtinë, fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertat për:

PASTRIMIN E RREGULLT PERIODIK TË FASADËS SË OBJEKTEVE TË BANKËS

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare, çmimet duhet të përfshijnë TVSH.
- dokumentacionin e nevojshëm mbi regjistrimin e biznesit dhe TVSH-në.
- referencat – kontratat mbi punë të ngjashme (2 vitet e fundit).

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku një muaj nga dita e dorëzimit.

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është deri më 22 Maj 2018 në ora 15:00.

Ofertat e pranuar pas këtij afati nuk do të hyjnë në procesin e selektimit.

Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për pastrimin fasadës së objekteve" duhet të dorëzohen në recepcion në lokalet e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike, Sh.A. Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në cdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nëna Terezë p.n
10000 Prishtinë, Kosovë

info@bekonomike.com
Tel. +383 (0) 38 500 500
Fax. +383 (0) 38 500 507

**FTESË PËR TENDER**

Banka fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertat për:

PLOTËSIMIN E NEVOJAVE VJETORE PËR MATERIAL SHPENZUES PËR ZYRE

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare.
- specifikacionet e kasafortave, katalogjet.
- dokumentacionin e nevojshëm mbi regjistrimin e biznesit dhe TVSH-në.
- referencat – kontratat mbi punë të ngjashme.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më 22 Maj 2018 në ora 15:00.

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku një muaj nga data e dorëzimit.

Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për material shpenzues për zyre" duhet të dorëzohen në recepcion në lokalet e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike, Sh.A. Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në cdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nëna Terezë p.n
10000 Prishtinë, Kosovë

info@bekonomike.com
Tel. +383 (0) 38 500 500
Fax. +383 (0) 38 500 507

**FTESË PËR TENDER**

Banka fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertat për:

SOFTUER PËR LEJIMIN/NDALIMIN DHE MONITORIMIN E ÇASJEVE NË PAJISJET FUNDORE ENDPOINT SECURITY

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare, çmimet duhet të përfshijnë TVSH.
- ofertën teknike
- dokumentacionin e nevojshëm mbi regjistrimin e biznesit dhe TVSH-në.
- referencat – kontratat mbi punë të ngjashme.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më 22 Maj 2018 në ora 15:00.

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku një muaj nga data e dorëzimit.

Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për Aplikacion për monitorimin e pajisjeve fundore" duhet të dorëzohen në recepcion në lokalet e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike, Sh.A. Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në cdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nëna Terezë p.n
10000 Prishtinë, Kosovë

info@bekonomike.com
Tel. +383 (0) 38 500 500
Fax. +383 (0) 38 500 507



FTESË PËR TENDER

Banka Ekonomike Sh.A. Prishtinë, fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertat për:

PLOTËSIMIN E NEVOJAVE VJETORE PËR FURNIZIM ME PAJISJE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE PËR ZYRE

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare, çmimet duhet të jenë me TVSH
- specifikacionet e pajisjeve.
- në ofertë duhet të ceket afati i garancionit si dhe afati i liferimit
- dokumentacionin e nevojshëm mbi TVSH-në dhe regjistrimin e biznesit
- referencat mbi punë të ngjashme.

Kompanitë ofertuese duhet të jenë të autorizuar për shitje të pajisjeve të kërkuara.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më 23 Maj 2018 në ora 15:00.

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nënë Terezë p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku një muaj nga data e dorëzimit.

Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për pajisje të TI për zyrë" duhet të dorëzohen në reception në lokalet e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike, Sh.A. Prishtinë, Sheshi Nënë Terezë p.n.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në cdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A	info@bekonomike.com
Sheshi Nënë Terezë p.n	Tel. +383 (0) 38 500 500
10000 Prishtinë, Kosovë	Fax. +383 (0) 38 500 507



FTESË PËR TENDER

Banka Ekonomike Sh.A. Prishtinë, fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertat për:

PLOTËSIMIN E NEVOJAVE VJETORE PËR MIRËMBAJTJE TË BANKOMATËVE

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare, çmimet duhet të jenë me TVSH
- specifikacionin teknik për pjesët rezervë
- dokumentacionin e nevojshëm mbi regjistrimin e biznesit dhe TVSH-në
- referencat – kontratat mbi punë të ngjashme.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më 23 Maj 2018 në ora 15:00.

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nënë Terezë p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku një muaj nga data e dorëzimit.

Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për mirëmbajtje të bankomatëve" duhet të dorëzohen në reception në lokalet e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike, Sh.A. Prishtinë, Sheshi Nënë Terezë p.n.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në cdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A	info@bekonomike.com
Sheshi Nënë Terezë p.n	Tel. +383 (0) 38 500 500
10000 Prishtinë, Kosovë	Fax. +383 (0) 38 500 507



FTESË PËR TENDER

Banka Ekonomike Sh.A. Prishtinë, fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertat për:

PLOTËSIMIN E NEVOJAVE VJETORE PËR FURNIZIM ME TONERË TË LLOJEVE TË NDRYSHME

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare, çmimet duhet të jenë me TVSH
- dokumentacionin e nevojshëm mbi regjistrimin e biznesit dhe TVSH-në
- në ofertë duhet të ceket garancioni si dhe afati i liferimit
- referencat – kontratat mbi punë të ngjashme.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më 23 Maj 2018 në ora 15:00.

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nënë Terezë p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com


Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku një muaj nga data e dorëzimit.

Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për furnizim me toner" duhet të dorëzohen në reception në lokalet e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike, Sh.A. Prishtinë, Sheshi Nënë Terezë p.n.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në cdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A	info@bekonomike.com
Sheshi Nënë Terezë p.n	Tel. +383 (0) 38 500 500
10000 Prishtinë, Kosovë	Fax. +383 (0) 38 500 507



044 900 978 | 045 681 898



Sallon Depilimi Lume's Details



lumesdetails



Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Merkeli dënon shkeljen e armëpushimit në Ukrainë

BERLIN, 13 MAJ - Kancelarja gjermane Angela Merkel është shprehur e shqetësuar lidhur me mospërfilljen e armëpushimit në mes të forcave ukrainase dhe separatistëve pro-rusë në lindje të Ukrainës. Këto adresime Merkel i bëri më 12 maj, ku u nderua me Çmimin për Paqe në Itali. Që nga prilli i vitit 2014 më shumë se 10

300 njerëz u vranë në luftimet mes forcave të Kievit dhe separatistëve që kontrollojnë pjesë të Donjeckut dhe Luhanskut. Armëpushimi ishte vendosur si pjesë e marrëveshjes së Minskut më 14 shtator. "Ukraina është duke na shqetësuar. Ne po përpiqemi ta forcojmë marrëveshjen e Minskut, por çdo natë bëhet

shkelje e kësaj marrëveshje, çdo ditë humbje jetësh", shtoi Merkel.

Një marrëveshje e re për armëpushim në mes të Ukrainës dhe Rusisë është arritur në fund të vitit 2017 dhe duhej të fillonte më 13 dhjetor. Të dyja palët kanë akuzuar njëra-tjetrën për dhunim të marrëveshjes.



Mbështetet Trumpi pas zhvillimeve me Phenianin

Presidenti Donald Trump shpreson se një përparim i madh në marrëdhëniet me Korenë e Veriut mund t'i përmirësojë vlerësimet për të në nivele të ulëta historike, të cilat kanë pësuar rritje në javët e fundit

WASHINGTON, 13 MAJ - Presidenti Donald Trump po shijon suksesin e vet më të madh në politikën e jashtme deri më sot, kthimin e tre amerikanëve që po mbaheshin peng prej shumë kohësh nga Koreja e Veriut. Presidenti shpreson se një përparim i madh në marrëdhëniet me Korenë e Veriut mund t'i përmirësojë vlerësimet për të në nivele të ulëta historike, të cilat kanë pësuar rritje në javët e fundit.

Presidenti Trump doli për ta pritur kthimin e tre amerikanëve të liruar nga Pheniani, një moment televiziv për një president që kërkon ta përmirësojë qëndrimin e tij politik në vend. "Ishte me rëndësi për të gjithë ne që ta siguronim lirin e këtyre tre njerëzve të mrekullueshëm", tha presidenti Trump.

Prej kohësh Trumpi është ankuar se nuk i njihet merita për ekonominë e fuqishme amerikane.

Shpesh ai sulmon medien rreth

asaj që ai e shesh si shqetësim të saj me hetimet mbi Rusinë të drejtuar nga prokurori special Robert Mueller. "Kemi papunësinë më të vogël ndonjëherë, ndërsa media flet për gjuetinë e shtrigave me Rusinë. Vetëm kjo dëgjohet", tha ai.

Trumpi zbatoi këtë edhe një premtim tjetër të fushatës me largimin nga marrëveshja bërthamore me Iranin, një lëvizje që nxiti kritika mes demokratëve si senatori Ben Cardin. "Tërheqja nga marrëveshja bërthamore e izolon Amerikën dhe ndihmon Iranin. Kjo shkon kundër objektivave tona për t'i kontrolluar këto lloje aktivitete", tha ai.

Mbështetja e publikut për presidentin është përmirësuar së fundmi, por ai ende mbetet një figurë polarizuese, thotë analisti John Portier nga Qendra për Politika Dypartiake. "Pozitat janë forcuar nga të dy krahët që pëlqejnë dhe nuk pëlqejnë Trumpin. Është interesante të shihet se mbështetja për të nuk ka



ndryshuar dramatisht në muajt e fundit, edhe pse duket se kanë ndodhur shumë gjëra", tha ai.

Që nga ardhja e tij në Shtëpinë e Bardhë, ai ka shpenzuar shumë kohë për ta bindur bazën se ai po ndjek premtimet e fushatës, thotë Henry Olsen nga Qendra për Etikën dhe Politikën Publike. "Sa më i politizuar të jesh, aq më shumë ka gjasa të jeni besnik i Trumpit dhe më shumë gjasa ka që të mendoni se Partia

Demokrate përbën kërcënim për Amerikën. Për rrjedhojë, çdo mjet është i nevojshëm për të luftuar atë kërcënim", tha Olsen. Edhe pse me përmirësime të vogla në mbështetje, Trumpi mbetet një forcë motivuese për demokratët në opozitë, thotë Bill Galston nga Instituti Brookings. "Mbështetja për punën e presidentit mbetet pranë niveleve historikisht të ulëta. Ka shenja se demokratët janë mobilizuar

shumë, ndërsa shumë të tjerë po kandidojnë nëpër poste", tha Galston.

Presidenti Trump shpreson ta mbajë fokusin tek ekonomia e brendshme dhe Koreja e Veriut, larg hetimeve për Rusinë dhe problemeve ligjore me të cilat përballet avokati i tij personal Michael Cohen, si dhe beteja ligjore lidhur me dyshimet për çështjen me aktoren e filmave pornografikë Stormy Daniels.



Erdogani nis vizitën në Britani të Madhe

LONDËR, 13 MAJ - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka nisur vizitën e tij në Britani të Madhe ku do të takohet me Mbretëreshën Elizabeta dhe kryeministren Theresa May nesër (e martë).

Para nisjes nga Stambolli,

Erdogani e quajti Britaninë "partnere strategjike dhe aleate" dhe tha se do t'i diskutojë çështjet bilaterale, rajonale dhe ndërkombëtare. Një ndër këto çështje janë edhe zhvillimet me Qipron, ku Turqia dhe Britania veprojnë si garantues si dhe një plan të për-

bashkët në Lindjen e Mesme, në veçanti në Siri, Irak dhe Iran.

Erdogani theksoi se takimet do të fokusohen në marrëdhëniet tregtare mes Turqisë dhe Britanisë. Ai shtoi se do t'i vazhdojë raportet ekonomike me Britaninë edhe pas Brexit.

Irakianët presin rezultatet e zgjedhjeve parlamentare

BAGDAD, 13 MAJ - Irakianët po presin rezultatet e zgjedhjeve qendrore që ishin kryesisht të qeta, por rezultuan me një kthesë të madhe të përcaktimit në mes të vendosjes së marrëdhënies më të ngushta me Iranin apo Perëndimin.

Komisioni i zgjedhjeve më 12 maj shënoi 44.5 për qind të daljes së popullatës, që është shifër shumë e ulët se 60 për qind në

zgjedhjet e kaluara. Rreth 22.5 milionë njerëz kanë të drejtë vote.

Autoritetet nuk kanë raportuar incidente, por banorët dhe disa zyrtarë deklaruan se dy grupe kurde kanë shkëmbyer zjarr në një rajon.

Këto janë zgjedhjet e para parlamentare që kur Bagdadi shpalli fitore nga Shteti Islamik, duke i larguar nga territori i tyre vitin e

kaluar.

Rezultatet zyrtare pritet të dalin më 14 maj dhe kryeministri do të zgjidhet me negociata për koalicion, procedurë që mund të shkojë me muaj të tërë.

Posti i kryeministrit është i rezervuar për komunitetin shi'itë, kryetari i Parlamentit do të jetë sunit dhe presidenca u takon kurdëve. Të gjitha postet zgjedhen nga Parlamenti.



Kosova dhe Maqedonia arrijnë marrëveshje në fushën e kinematografisë

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Në Festivalin e Kanës, Qendra Kinematografike e Kosovës dhe Agjencia e Filmit e Maqedonisë kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëprodhimit në fushën e filmit. I pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj marrëveshje ishte edhe ministri i Kulturës, Kujtim Gashi, i cili ka thënë se është kënaqësi e veçantë të jetë i pranishëm me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, e cila, sipas tij, do të shërbejë edhe më shumë për bashkëprodhimet në fushën e filmit, por edhe të njohjes së kulturës ndërmjet dy vendeve. "Ministria e Kulturës çdoherë do të jetë afër iniciativave të

tilla që i fuqizojnë marrëdhëniet ndërfqinjësore", ka thënë ministri Gashi. Drejtori i Qendrës Kinematografike të Kosovës, Arben Zharku, ka thënë se ky është një moment shumë i veçantë sepse nënshkruhet marrëveshja e parë e këtij lloji me shtetin fqinj me të cilin Kosova ka një histori të shkëlqyeshme të bashkëprodhimit të filmit. Maqedonia është një ndër mbështetëset më të mëdha të kinematografisë së Kosovës. Vetëm brenda vitit të fundit katër projekte kanë gjetur mbështetje nga shteti i Maqedonisë. Kosova pritet të nënshkruajë marrëveshje të bashkëprodhimit edhe me disa shtete të tjera fqinje.



Ministri Gashi: Kinematografia e Kosovës, shembull i suksesit

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar pavijonin e Kosovës në Kanë, ku është pritur nga drejtori i Qendrës Kinematografike të Kosovës, Arben Zharku dhe kryetari i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë, Ilir Butka. Të dy drejtorët e njoftuan min-

istrin Gashi për rrjedhën e punëve në Festivalin e Kanës dhe prezantimin e kinematografisë së Kosovës dhe Shqipërisë që po bëhet në tregun më të madh të filmit në botë. Pastaj, ministri Gashi ka zhvilluar edhe disa takime me udhëheqës të pavijoneve të vendeve të ndryshme. Ai ka takuar drejtorin e Fondit

Izraelit të Filmit, Katriel Schorry, të cilin e ka falënderuar për ndihmën e veçantë që i ka dhënë kinematografisë së Kosovës. Ministri Gashi ka takuar edhe përfaqësuesit e pavijonit të Turqisë dhe artistë turq, të cilët i ka inkurajuar të bashkëpunojnë edhe më shumë me Kosovën.

Kalaja e Beratit për katër muaj priti mbi 27 mijë turistë

PRISHTINË, 13 MAJ - Monumentet e kulturës në Shqipëri çdo ditë e më shumë po tërheqin vëmendjen e turistëve, sidomos atyre të huaj. Berati është një ndër qytetet më interesante dhe tërheqës, i cili çdo vit e më shumë po tërheq turistë të huaj dhe vëmendjen e medieve të huaja. Kalaja e Beratit është një ndër pikat turistike e cila ka një numër vizitorësh që vjen gjithnjë në rritje. Ajo përbën një nga atraksionet turistike më të preferuara në Shqipëri për turistët e huaj dhe ata vendës. Drejtorja Rajonale Kombëtare Kulturore në Berat ka njoftuar se është rritur numri i vizitorëve



për periudhën janar - prill të këtij viti, krahasuar me të njëjtën periudhë të tri viteve të fundit. Sipas kësaj drejtorie, për

këtë vit numri i turistëve ka arritur 27 468 vizitorë, 12 mijë vizitorë më shumë se në periudhën paraprake.

‘Hana’ mbështetet edhe nga Agjencia Maqedonase e Filmit

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Agjencia Maqedonase e Filmit ka publikuar rezultatet e projekteve filmike fituese të konkursit të tyre të fundit, ku projekti filmik "Hana" i regjisorit Ujkan Hysaj është një ndër ta.



"Hana" me skenar nga Fadil Hysaj dhe producent Kushtrim Koliqi është mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës në vitin 2017 dhe për temë ka Sarën, një aktore e dhunuar gjatë luftës në Kosovë e që bëhet protagoniste e një

filmi të huaj që ka për temë dhunimin. Ndërsa përjeton të njëjtat situata, më në fund arrin ta lirojë veten nga trauma e saj. Ky është i katërti projekt filmik nga Kosova që brenda një viti gjejnë mbështetjen nga Maqedonia.

Zgjedhet përbërja e Këshillit Drejtues të Teatrit "Dodona"

PRISHTINË, 13 MAJ (ER) - Teatri "Dodona" në Prishtinë ka zyrtarizuar përbërjen e re të

Këshillit Drejtues të këtij ambienti kulturor. Në komunikatën e dërguar thuhet se Këshilli

Drejtues përbëhet nga emra të njohur të botës së artit si: Doruntina Basha - dra-

maturge, Enver Petrovci - aktor, Hana Qena - dramaturge, Kushtrim Koliqi -

dramaturg dhe Bekim Sele - përfaqësues i Komunës së Prishtinës.

E rrallë**I vjen sms nga telefoni i babit të vdekur, shokohet**

Gjashtë vjet më parë një 37-vjeçar, i quajtur Stephen, humbi tragjikisht babanë e tij të sëmurë me kancer në mushkëri. Gjashtë vjet më pas, ai është habitur kur në telefonin e tij ka mbërritur një mesazh ku shkruhej thjesht "test" nga numri i të atit. Konfuzioni kaloi kur



ai ka kuptuar se mamaja e tij e kishte përdorur telefonin e vjetër të babait.

FOTO E DITES

Tre njerëz shihen duke lundruar me anije mbi lumin Main në Frankfurt. /AP/

E jashtëzakonshme**Deti nxjerr në breg krijesën misterioze**

Një krijesë gjigante misterioze ka dalë në breg të detit në një plazh në Filipine, duke shkaktuar frikë te banorët, të cilët mendojnë se është një shenjë se një katastrofë natyrore është duke ardhur në zonë. Kjo gjallesë ka zgjuar kureshtje të madhe te banorët, të cilët në numër të shumtë shkuan ta shihnin.



Shkencëtarët kanë bërë me dije se kjo gjallesë ka gjasë të vijë nga një planet tjetër.

BARSOLETA E DITËS

Mësuesi, nxënësit:

- Ma thuaj emrin e një qyteti në Angli.
- Për cilin qytet e keni fjalën?

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

**DASHI**

Gjatë ditës së sotme do t'ju duhet ta gjeni ekuilibrin e artë midis arsyes dhe ndjenjës në mënyrë që mbrëmja të jetë e qetë.

**DEMI**

Çdo gjë në kohën e saj, kjo duhet të jetë motoja juaj ditën e sotme. Nëse përshpejtoni kohët nuk do të thotë se do të zgjidhni punë.

**BINJAKËT**

Mbani në nivele të larta humorin tuaj sepse sot do të keni vërtet nevojë. Do të ndodhin situata që vetëm falë një humori të mirë mund t'i përballoni.

**GAFORRJA**

Sot po arrini drejt fundit të një projekti vërtet të rëndësishëm për ju. Jeni të mbushur plot optimizëm që gjërat e mira realizohen gjithmonë.

**LUANI**

Sot do të jetë e rëndësishme të mos lëndoni askënd, por një fjalë e thënë pa u menduar do t'i shkaktojë shumë mërzë një mikut tuaj.

**VIRGJËRËSHA**

Është momenti t'i rishikoni në detaje hapat e marrë në fusha të ndryshme të jetës. Mbase duhet të bëni hapa pas një fushe të caktuar.

**PESHORJA**

Sot duhet të gëzoheni edhe për gjërat e vogla. Mos hezitoni ta shfaqni buzëqeshjen tuaj kudo ku keni mundësi.

**AKREPI**

Nëse nuk ndiheni mirë me veten sot, nuk duhet të merrni përsipër përgjegjësi që mbase në të ardhmen do t'ju kthehen kundër.

**SHIGJETARI**

Ata që kanë besim tek ju sot do t'ju kërkojnë mbështetje për një çështje të caktuar.

**BRICJAPI**

Sot mund t'ju dalin vështirësi që nuk i kishit menduar më parë. Mbrëmje e qetë në shoqërinë e partnerit që do t'ju bëjë ta harroni ditën e ngarkuar.

**UJORI**

Do të krijoni përvoja të reja dhe fitimprurëse në fusha që ju nuk i kishit menduar aspak. Mjafton pak kurajë dhe çdo gjë zgjidhet.

**PESHQIT**

Ua keni zbuluar ndjenjat tuaja personave pranë jush dhe nuk po e kuptoni nëse keni bërë mirë apo keq, duke parë situatat që po ndodhin.


Kendall Jenneri shkëlqen në Kanë



22-vjeçarja Kendall Jenneri ka magjepsur të gjithë me veshjen e saj gjatë festivalit të filmit në Kanë që u zhvillua këtë fundjavë në

Francë. Modeluesja bukuroshe u shfaq në tapetin e kuq me një fustan të bardhë ku dukej si një mbretëreshë.

Truproja e Kylie Jennerit thyen heshtjen: Nuk jam unë babai i foshnjës



Fansat e Kylie Jennerit dolën me një teori të çuditshme ku pretendonin se truproja e saj, Tim Chung, ishte babai i fëmijës Stormi. Por, truproja ka thyer heshtjen e tij për këtë çështje. Teoritë e çuditshme filluan pasi fansat krahasonin fotografitë e vogëlushes

me Timin. Ky i fundit ka shkruar në rrjetin social "Instagram" se këto dyshime janë qesharake. "Marrëdhëniet e mia me Kylien dhe familjen e saj kanë qenë shumë të kufizuara në mënyrë rigoroze dhe vetëm profesionale", ka shkruar Timi.



Pierce Brosnan, rrugëve të Nju Jorkut me gruan

Pierce Brosnan ka 24 vjet që është bashkë me gruan, Shaye Smith, dhe duket të jetë ende shumë i lidhur me të, sikurse në fillet e para të dashurisë së tyre. Ishin takuar në një plazh në Meksikë më 1994, ndërkaq këtë

fundjavë ata u panë prapë bashkë, por kësaj radhe të kapur dorë për dore teksa shëtisnin rrugëve të Nju Jorkut. Edhe aktori irlandez, por edhe bashkëshortja e tij, kishin zgjedhur të visheshin thjesht në daljen e tyre për drekë.

Izraeli fiton këngën e Eurovisionit



Izraeli ka fituar Eurovisionin 2018. Ky shtet u përfaqësua nga këngëtarja Netta me këngën "Toy". Shqiptarja Eleni Foureira zuri vendin e dytë për Qipron, e cila është pritur

mjaft mirë nga publiku në sallë. Ishte e vetmja pjesëmarrëse që kishte një performancë aq shpërthyes, me një këngë ritmike, me të cilat tashmë ajo personifikohet.

EURO GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT Pilkington
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

QENDRA SPORTIVE

“BUJQËSIA”

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	NK SLAVEN - ISTRA	1	VAASA - FC HONKA	1	KALMAR - IK SIRIUS	3+
-------------------	-------------------	---	------------------	---	--------------------	----

Besa, bindëse kundër Vllaznisë

PRISHTINË, 13 MAJ - Besa e Pejës e ka fituar bindshëm ndeshjen e fundit në xhiron e parafundit në këtë edicion të Vala Superligës së Kosovës në futboll kundër Vllaznisë së Pozharanit me rezultat 4-1. Adis Salihu shënoi dy gola, derisa Fetim Kasapi dhe Fatlum Gashi kontribuan me nga një gol tjetër. Ndërkaq, golin e nderit për vendësit e shënoi Valentin Pirani. Vllaznia dhe Besa në edicionin e ardhshëm do të bëjnë gara në Ligën e Parë. Ndërsa të shtunën janë zhvilluar dy ndeshje në kuadër të javës së 32-të në Vala Superligë, Gjilani - Drenica e Feronikeli - Vëllaznimi dhe që të dyja u mbyllën pa fitues. Ashtu sikurse për titull, edhe për skuadrën e fundit që do të luajë në barazh do të vendosë java e fundit e kampionatit. Do të jetë pikërisht sfida ndërmjet Vëllaznimit dhe Gjilanit ajo që do të përcaktojë se cila nga to do ta sigurojnë mbetjen në elitë, e cila do të luajë në barazh. Ndeshja në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas ka dhuruar dramë të



vërtetë në minutat e fundit. Feronikeli kaloi në epërsi në minutën e tretë shtesë, kur pas një kundërsulmi të shpejtë Milicaj e shërbeu Hamed Konen në zonë dhe ky pa ndonjë problem e dërgoi topin në rrjetën e Muhaxhirit. Kur u mendua që Feronikeli përfundimisht do ta shijojë fitoren pas gjashtë ndeshjeve, në aksionin e fundit të ndeshjes Tun Bardhoku realizoi një eurogol nga distanca, duke shtangur fut-

bollistët vendës dhe duke i dhuruar një pikë të rëndësishme skuadrës së tij, pasi tashmë Vëllaznimi e ka në duart e veta fatin e mbetjes në elitë. Me rezultat identik sikurse në Drenas u mbyll edhe përballja ndërmjet Gjilanit dhe Drenicës, por këtu të dy golat u shënuan në pjesën e parë. Të parët në epërsi kaluan gjilanasit me golin e Betim Haxhimusës, në minutën e gjashtë, por shifrat i barazoi Denis

VALA SUPERLIGA / JAVA E 32-TË		LIGA E PARË	
Vllaznia - Besa	1-4	Trepça-Hajvalia	4-0
Gjilani - Drenica	1-1	Ramiz Sadiku-Bashkimi (K)	2-2
Feronikeli - Vëllaznimi	1-1	Fushë Kosova-KEK-u	1-2
Drita - Trepça '89	3-1	Vushtrria-Ballkani	0-0
Liria - Prishtina	0-1	2 Korriku-Kosova (P)	3-0
Llapi - Flamurtari	3-1	Ferizaj-Onix	0-0
		Vitia-Kika	0-1
		Dukagjini-Rahoveci	3-3
TABELA		TABELA	
1. Drita	66 pikë	1. KEK-u	65 pikë
2. Prishtina	63	2. Ballkani	64
3. Llapi	51	3. Vushtrria	60
4. Trepça '89	50	4. Ferizaj	51
5. Drenica	47	5. Onix	45
6. Liria	47	6. Fushë-Kosova	44
7. Feronikeli	45	7. Bashkimi (K)	37
8. Gjilani	45	8. 2 Korriku	33
9. Vëllaznimi	43	9. Ramiz Sadiku	36
10. Flamurtari	25	10. Vitia	35
11. Besa	22	11. Dukagjini	34
12. Vllaznia	14	12. Trepça	35
Në xhiron e radhës takohen: Prishtina-Drita, Flamurtari-Feronikeli, Besa-Llapi, Vëllaznimi-Gjilani, Drenica-Liria, Trepça '89-Vllaznia (P).		13. Kika	33
		14. Rahoveci	31
		15. Hajvalia	26
		16. Kosova (P)	9

Peposhi, në minutën e 25-të. Pas këtij barazimi Drenica e pret javën e fundit e qetë, derisa Gjilani duhet të arkëtojë një pikë në Gjakovë në duel me Vëllaznimin për t'iu shmangur

barazhit, në të kundërtën do të jetë i detyruar ta kërkojë mbetjen në elitë nëpërmjet barazhit, pasi edhe nëse mbetet me pikë të njëjta me Feronikelin ka bilanc më të keq në ndeshjet e ndërsjella.

Bashkimi e fiton finalen e parë kundër Prishtinës

PRISHTINË, 13 MAJ - Në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në kryeqytet është zhvilluar ndeshja e parë e serisë finale të 'play-off'-it ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Bashkimit, ku ekipi nga Prizreni doli fitues (81-84). Skuadra mysafire e nisi më mirë sfidën duke e fituar çerekun e parë me pesë pikë epërsi (22:27). Ende më bindëse ishte paraqitja e prizrenasve në dhjetëminutëshin e dytë, në të cilin i shënuan 21 pikë kundrejt nëntë pikëve të vendësve (9:21) dhe shkuan në pushim me avantazh të lartë (31-48). Në çerekun e tretë, bardhekaltrit tentuan të riktheheshin në lojë dhe shënuan dy pikë më shumë se kundërshtari (23:21). Një paraqitje shumë të mirë nikoqirët bënë në fillim të pjesëlojës së fundit duke i



shënuar 15 pikë në seri pa pranuar asnjë. Tri treshe rresht nga Filip Bundoviq ishin vendimtare në këtë rikthim. Megjithatë, Bashkimi u rikthye për ta mbajtur epërsinë dhe, pavarësisht që e humbi çerekun e fundit (27:15), e

fitoi ndeshjen me tri pikë epërsi (81-84). Ndeshja e dytë e serisë finale zhvillohet në palestrën "Rexhai Surroi" në Prizren dhe kësaj radhe Bashkimi do ta ketë edhe epërsinë e terrenit vendës dhe mbështetjen e tifozëve.

‘Shaoolinat’ fitojnë turnirin ‘Demush Mavraj’

ISTOG, 13 MAJ - Ekipi i futbollit "Shaoolinat" nga Saradrani i Istogut ka fituar turnirin tradicional "Demush Mavraj", organizuar për nder të veprimtarisë kombëtare të këtij dëshmori të kombit. Turniri në këtë edicion është mbajtur në Gjimnazin "Haxhi Zeka", kurse ekipi "Shaoolinat" ishte më i miri në këtë turneu dhe në finale e mposhti ekipin "Uniks-Events", pas penalltive, kurse kohën e rregullt të ndeshjes e kishin përfund-

uar me rezultat 1-1. Ekipteve pjesëmarrëse u janë dhënë mirënjohje, kurse dy ekipteve të para medalje dhe Kupa nga djali i dëshmorit Demush Mavraj, Artani. Organizatori i këtij turneu, Riza Mavraj, ka bërë me dije se gjithçka ka shkuar në mënyrën më të mirë, kurse ka premtuar se tradita për mbajtjen e turnirit për profesorin e Edukatës Fizike dhe dëshmorin e kombit, Demush Mavraj, do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.



Mercedesi i rikthehet dominimit, Ferrari telasheve

BARCELONË, 13 MAJ - Ferrari duket se është rikthyer te telashet dhe Mercedesi te dominimi. "Kokëkuqja" ishte larg nisjes së këtij sezoni te Formula 1 edhe në garën për

Çmimin e Madh të Spanjës. Lewis Hamiltoni dhe Valtteri Bottas kaluan njëri pas tjetrit vijën e fundit në pistën e Barcelonës, duke lënë pas tyre Verstappenin me Red Bullin.

Krenaria e Ferrarit në fushë u ruajt vetëm nga Sebastian Vetteli, edhe ky i pafuqishëm për të shkuar përtej vendit të katërt. Ndërkohë, Kimi Raikkoneni braktisi garën në

xhiron e 26 për një problem teknik me makinën. Ecuria e kësaj gare u përcaktua që në kthesat e para të startit. Romain Grosjean ishte protagonist i një përplasjeje, që bëri të hyjë në

pistë makina e sigurisë. Kjo ngadalësoi ritmin me të cilën Ferrari nisi garën dhe sidomos të Sebastian Vettelit, që në start mori vendin e dytë, duke parakaluar Bottasin.

Salah: Mos më krahasoni me Messin dhe Ronaldon

Liverpool, 13 maj - Mohamed Salah ka shkëlqyer në këtë edicion me fanellën e Liverpoolit, duke bërë që shumë analistë ta shohin si kandidat për ta fituar "Topin e Artë". Ai ka thënë se nuk

i pëlqen aspak krahasimi me Lionel Messin dhe Cristiano Ronaldon. "Nuk dua të them se jam i lumtur me këto krahasime. Secili prej tyre ka qenë në nivel të lartë për 10-11 vjet. Unë duhet t'i

ruaj nivelet e larta për shumë sezone. Shpresoj ta bëj këtë. Ata janë futbollistë të shkëlqyer. Se cili është më i miri në histori, unë nuk e di. Por do t'ju them se ata më kanë frymëzuar kur kam qenë

i ri dhe i kam admiruar. Zidan, Ronaldo dhe Totti janë ata që më kanë pëlqyer më shumë. I kam admiruar teksa i shikoja. Unë nuk kam parë Maradonën apo Pelenë", ka thënë Salah.



Josa: E dua titullin me Prishtinën

Prishtinë, 13 maj - Trajneri i Prishtinës, Mirel Josa, ishte i ftuar në emisionin 'Zona Gol', në "Supersport", ku foli për përvojën e tij në Kosovë. Ish-tekniku kampion me Skënderbeun, deklaroi se synon të fitojë edhe me Prishtinën, në Kosovë, ku është ende në lojë për të triumfuar si në kampionat, po ashtu edhe në Digitalb Kupë.

Si ndiheni te Prishtina?

Josa: Është një përvojë mjaft e mirë, të cilën e vlerësoj shumë dhe jam i kënaqur që jam këtu. Normalisht se futbollit i Kosovës ka problemet e veta, por gjithsesi zhvillohet një kampionat shumë interesant.

Duket se ngjyrat bardheblu ju ndjekin pas...

Josa: Po, është e vërtetë, sepse ashtu si te Tirana, edhe Prishtina ka fanellën bardheblu. Gjithsesi unë kam drejtuar edhe skuadra si Skënderbeu e Vllaznia, që kanë ngjyra të tjera.

Në dy takimet e fundit keni marrë fitore vetëm në minutat e fundit të ndeshjes. Duhet të jeni bërë me zemër...

Josa: Në fakt, kemi pasur ndeshje shumë të vështira dhe jo më kot kemi vuajtur për ta marrë fitoren. Veçanërisht ndeshja e fundit në Prizren, kundër Lirisë, më bëri vërtet me zemër, pasi ishte një takim nga i cili prisnim të shënonim, por e dinim se edhe mund të pësonim.

E mendonit në fillim të sezonit se Prishtina dhe Drita ishin skuadrat më të mira?

Josa: Të jem i sinqertë jo, madje as tani nuk jam i këtij mendimi. Këtu ka disa skuadra që janë shumë të mira, por që për një arsye apo për një tjetër, ndoshta edhe për shkak të fatit, gabuan në momente të caktuara dhe mbetën disi më mbrapa në renditje. Por, nuk janë për t'u nënvlerësuar skuadrat si Liria, Trepça '89 etj.

Jeni përgatitur për ta fituar titullin kampion?

Josa: Kemi punuar shumë që në fillim, me synimin e vetëm ta fitojmë titullin kampion. Unë kam fatin se



në Prishtinë punohet në kushte mjaft të mira, ndërsa në fazën përgatitore të dimrit arritëm të realizojmë gjëra mjaft të bukura. Gjithsesi them se jemi penalizuar disi, pasi infrastruktura në Kosovë është problematike dhe në shumë fusha, terreni nuk na ka lejuar të shprehim më të mirën tonë.

Si paraqitet Drita në transfertë?

Josa: Drita ka bërë ndeshje shumë të mira, si në shtëpi, po ashtu edhe në transfertë. Nuk humbet prej shumë javësh, më shumë se 20 mesa kujtoj dhe ka disa lojtarë shumë cilësorë, 2-3 prej të cilëve kanë luajtur edhe në Superligën Shqiptare. Besoj se do të jetë një sfidë e hapur, ku si ne ashtu edhe Drita kemi synimet tona për të fituar. Ata kanë edhe avantazhin e tri pikëve me vete, por kjo nuk na pengon ta provojmë triumfin.

Këtë sezon Prishtina po ndërton stadiumin dhe ka luajtur në Pejë ndeshjet e veta. Mund të themi se ky është një vit zero, ku titulli nuk është domosdoshmëri?

Josa: Nëse ka një gjë që mund ta vlerësoj në Kosovë dhe që nuk e kemi ne në Shqipëri, është se këtu punohet shumë qetë. Ka shumë optimizëm në ambientet e skuadrave dhe për më tepër nuk të ngarkojnë me objektiva e përgjegjësi të parakohshme. Më pëlqen kur gjërat merren me radhë dhe mendon me qetësi edhe për synimet që kërkon të arrish.

Do të donit që finalja e sezonit

kundër Dritës të luhet në Prishtinë?

Josa: Dëshira jonë do të ishte të luanim në Prishtinë, jo vetëm se jemi në qytetin tonë, por edhe sepse masat e sigurisë janë më të mira, pasi bëhet fjalë për dy skuadra me tifozë të zjarrtë. Por në pamundësi për ta zgjedhur Prishtinën, ne kemi luajtur të gjitha takimet në Pejë, një qytet që na ka mirëpritur dhe kemi gjetur ngrohtësinë e duhur. Ishte edhe një opsion për të luajtur në Mitrovicë, por unë mendoj se Peja është zgjidhja më e mirë për këtë sfidë, pasi aty kemi luajtur gjithë sezonin dhe jemi përgatitur për lojën në atë terren.

Çfarë ju pengon të luani në Prishtinë?

Josa: Stadiumi këtu është i ri dhe shumë cilësor, por nuk është licencuar ende nga UEFA dhe kjo është pengesa që është shfaqur deri tani. Nuk është luajtur ende asnjë ndeshje testuese, përpara se të luhet një ndeshje zyrtare, ndaj është e vështirë të vendoset që ndeshja me Dritën të luhet aty.

Jeni ambientuar në Prishtinë, apo jeni me mendje diku tjetër?

Josa: Kontrata ime me klubin e Prishtinës përfundon pas finales së Digitalb Kupës dhe më pas do të analizojmë gjithçka. Do të ulem me administratën e klubit dhe do të diskutojmë. Nëse unë jam i kënaqur me atë që më ofrohet dhe ata kanë vlerësim për punën time, atëherë pse mos ta vijojmë ende bashkëpunimin.

SHKURT

KH "Shqiponja", anëtare e barabartë në WFCH

KH "Shqiponja" është anëtare e barabartë e WFCH (Women Forum Club Handball). Ky vendim është marrë në Asamblenë Gjenerale të WFCH-së që është mbajtur në Budapest të Hungarisë. Punimet e Asamblesë Gjenerale i përshëndeti edhe zëvendës-presidenti i EHF-së, Bosković dhe sekretari gjeneral, Hausleitner.

KH "Shqiponja" u përfaqësua nga drejtori i saj, prof. dr Artan Nimani dhe menaxheri për marrëdhënie me jashtë, Denis Spahija, i cili njëherësh edhe u zgjedh pjesë e forumeve të drejtësisë në WFCH.

Asambleja rizgjodhi president Zsolt Akos Janey nga Hungaria, nënpresidentë Dija Ivanovićin nga Sllovenia dhe Thomas Hylen nga Danimarka, komitetin ekzekutiv nga në përbërje të 11 anëtarëve dhe gjermanin Gerd Butzeck, drejtor menaxhues.

Al Khelaifi: Neymari qëndron te PSG-ja

Pasi festoi titullin kampion të Paris Saint Germainit në Francë, presidenti i klubit francez, Nasser Al Khelaifi, u pyet për të ardhmen e Neymarit. Al Khelaifi dha një përgjigje të prerë: "Do të qëndrojë 2000 %. Jam i sigurt për këtë. Ai dëshiron të qëndrojë te PSG-ja". Deklarata të tilla mbështesin ato të Neymarit, i cili, për t'i qetësuar tifozët, u shpreh mbi një largim të mundshëm te Real: "Jam i nderuar që mbaj këtë fanellë dhe dua t'i gëzoj fansat tanë".

"Le Parisien" ka shkruar ditët e fundit se sulmuesi brazilian u ka thënë shokëve të ekipit se dëshiron të transferohet te Real i Madridit. Operacioni do të jetë i vështirë, pasi PSG-ja nuk do ta shesë për më pak se 300 milionë euro një futbollist që e bleu verën e kaluar për 222 milionë euro.

Kvitova triumfon në Madrid

Tenistja çeke Petra Kvitova fitoi turneun Masters të Madridit, duke mundur 2-1 në finale holandezen Kiki Bertens (7-6, 4-6, 6-3), një ndeshje që zgjati gati tri orë. Dy teniste që dhanë maksimumin e tyre në fushë, por në fund triumfoi përvoja e Kvitovës, nga e hëna do të jetë numri 8 në botë për femra, që konfirmoi momentin e mirë që po kalon. Për çeken ky është trofeu i katërt sezon-al, pas atyre që ka fituar në Doha, Shën Petërburg dhe Praga, duke qenë gati për grand slem-in e Roland Garros që nis pas 10 ditësh.

Emery, pasardhës i Wengerit tek Arsenal

Trajneri Unai Emery është favorit për ta marrë drejtimin e Arsenalit. "Daily and Sunday Express" njofton që palët kanë zhvilluar negociatat dhe Emery mund të jetë pasardhës i trajnerit Arsene Wenger. Emery do të largohet nga PSG-ja, ku dështoi të marrë rezultate pozitive në Evropë.

Besa dhe Prishtina, afër finales në hendboll

PRISHTINË, 13 MAJ - Besa FamGas e Prishtina kanë bërë hapin e parë drejt finales së "play-off"-it në kampionatin e Kosovës në hendboll. Në ndeshjet e para gjysmëfinale, Besa fitoi kundër Dritës, ndërsa Prishtina kundër Kastriotit.

Këtyre dy skuadrave në ndeshjet e dyta, që luajnë si mysafire, u mjaftojnë barazimet për të kaluar në finale. Kampionia aktuale, Besa, fitoi shumë thellë kundër Dritës së Gjilanit me rezultatin 40:13. Pas pjesës së parë rezultati ishte 20:9 në të mirë të pejanëve,

por në të dytën dallimi mes skuadrave ishte edhe më i madh. Besa ua dha rastin shumë lojtarëve të rinj në këtë ndeshje pa rivalitet. Besa stinorin e rregullt e ka përfunduar në vendin e parë, ndërsa Drita në të katërtin. Vëllezërit

Tahirukaj me 13 gola së bashku ishin kryesorët te Besa, te Drita Selmani dhe Sllamniku me nga tre gola. Ndërkohë, Prishtina fitoi kundër Kastriotit të Ferizajt me rezultat 31:24. Pas pjesës së parë rezultati ishte i barabartë, 14:14. Terziqi ishte më efikas te



Prishtina me 11 gola. Dhjetë herë për Kastriotin shënoi Sylja.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i
Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports
DEPARTAMENTI I RINISË/ DEPARTMAN MLADIH/ DEPARTMENT OF
YOUTH

Prishtinë, 14 Maj 2018

FTESË PUBLIKE PËR PROJEKT PËR EDUKIM

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit bazuar Planin e Veprimit për Punësimin e të rinjve 2018-2020 si dhe Rregulloren MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve fton të gjitha Organizatat Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Edukimit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në Edukimin e të rinjve përmes edukimit jo-formal (trajnimeve, seminareve, punëtorive, tryezave të rrumbullakëta, panaireve, konferencave, vizitave studimore) etj dhe informal.

Qëllimi kryesor i kësaj Ftese Publike është Promovimi i vlerave demokratike dhe qytetarisë aktive tek të rinjtë përmes edukimit global dhe krijimit i kulturës së të mësuarit gjatë gjithë jetës duke ju ofruar të rinjve aftësitë dhe njohuritë që ata kanë nevojë për të përparuar në një shoqëri të globalizuar.

Ngritja e kapaciteteve tek të rinjtë përmes edukimit jo formal dhe informal mbështet zhvillimin e tyre, duke ndihmuar në transformimin e potencialit, kreativitetit, talentit, iniciativës dhe përgjegjësisë sociale, nëpërmjet përvetësimit të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave.

Këto trajnime, seminare, punëtori, debate, tryeza, panaire, konferenca etj do të përdoren për të ndihmuar të rinjtë e moshës 15-24 vjeç që të zhvillojnë shkathtësi, kompetenca dhe qëndrime në disa nga tematikat si në vijim:

Tematikat:

- Edukimin mbi të drejtat e njeriut;
- Edukim për Lidership;
- Edukim për advokim dhe lobim;
- Organizimi i TEDx, ku organizon ngjarje të stilit të TED-it diku dhe kudo - duke festuar idetë e nxitura në nivel lokal dhe duke i ngritur ato në një fazë globale. Ngjarjet TEDx duhet prodhuar në mënyrë të pavarur nga konferencat TED, por bazuar në formatin dhe rregullat e TED
- Edukim për tolerancën, paqen dhe reduktimin e konflikteve;
- Edukim për qytetari demokratike;
- Organizimin e konferencave ku përfitojnë të rinjtë;
- Organizimin e panaireve;
- Edukim mbi Shkathtësitë e komunikimit;
- Edukim mbi zhvillimin e teknikave të shkathtësive Debatuese;
- Shkathtësitë e mendimit Kritik;
- Shkathtësitë e Zgjidhjes së problemit;
- Përmisimi i aftësive të të folurit në publik (public speaking);
- Sallone;

Buxheti total tentativ i paraparë për këtë thirrje është 50,000 Euro dhe përmes tij planifikohet të përkrahen 10-15 organizata.

OJQ-të në përputhje me këtë ftesë publike mund të aplikojnë me vetëm një projekt

OJQ-të të cilat kanë përfituar nga DiR gjatë vitit 2018 nuk mund të aplikojnë me projekt.

Kriteret e përgjithshme për OJQ-të:

Për t’u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës.
- të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; dhe
- të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Kriteret Specifike

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar dhe të hyjë në fazën e vlerësimit nga aspekti përmbajtësor, aplikuesi duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

- të dorëzojnë brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike (jo përshkrim i objektivës së ftesës), aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike;
- projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe Manualit për zbatimin e kësaj Rregulloreje.
- të dorëzojë të dhëna për personelin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimi (para marrëveshje) nga ana e tyre se do të punojnë për projektin;
- të dorëzojë CV dhe kopjet e diplomave të trajnerëve (minimalisht 2 trajnerë të përfshirë në trajnime) me një deklaratë pranimi (para marrëveshje) nga ana e tyre se do të punojnë për projektin;

- i gjithë dokumentacioni duhet të përmbaj një kopje fizike dhe i njëjti në mënyrë elektronike në CD

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme dhe specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk mund të kualifikohet për mbështetje financiare.

Kriteret e vlerësimit nga aspekti përmbajtësorë:

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve të vlerësojë me sa vijon:

- A posedon OJQ-ja përvojë të mjaftueshme dhe kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit /programit (duke përfshirë personelin, pajisjet dhe aftësinë për të udhëhequr me buxhetin si dhe referenca për projekte të ngjashme)?
- A posedojnë trajnerët e angazhuar në projekt përvojë të mjaftueshme dhe kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit /programit (a kanë aftësitë e duhura dhe aftësitë për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë ftesë publike)?
- A ka një strukturë të qartë brenda OJQ-së që do të merret me menaxhimin e projektit (a është e përcaktuar qartë ekipi i projektit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit) ?
- Sa relevant është projekt-propozimi për qëllimet dhe fushat prioritare të Ftesës Publike (a ndërlidhen projekti me aktivitetet e parapara në Strategjinë për Edukimin e të rinjve përmes edukimit jo-formal dhe politikat prioritare)?
- A janë objektivat e projektit/programit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?
- A janë aktivitetet e projektit / programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
- A janë përcaktuar qartë rezultatet dhe nëse aktivitetet çojnë në arritjen e rezultateve?
- A ka arritur projekti/programi të përcaktojë në mënyrë të qartë përdoruesit (numrin, moshën, gjininë, fokusin rajonal etj)? A përcakton dhe në çfarë mase adreson problemet dhe nevojat e tyre projekti?
- A janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?
- A janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit/programit?

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është deri më **1 Qershor 2018**

Periodha e zbatimit të projektit është maksimum 5 muaj. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt për një (1) regjion të caktuar

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (www.mkrs-ks.org).

Dokumentet e kompletuara mund të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Departamenti i Rinisë.

Sheshi Nëna Terezë; Zyra e Arkivës, Nr. 22; 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD duhet të vendosen në një zarf të mbyllur me mbishkrimin (**Aplikim për projekte për edukim global dhe krijimit i kulturës së të mësuarit gjatë gjithë jetës si dhe emrin e OJQ-së**). Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur.

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të ftesës publike janë të detajuara në **Udhëzuesin për Aplikim**.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë ftese publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

MKRS do të mbaj një sesion informuese për të gjithë aplikantët potencial: **23 maj 2018, ora 11:00 - në zyrat e MKRS/DiR**.

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: flora.salihu@rks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports
DEPARTAMENTI I RINISË / ODELJENJE ZA OMLADINU / DEPARTMENT OF YOUTH

Priština, 14 Maj 2018

JAVNI POZIV ZA PROJEKAT ZA OBRAZOVANJE

Ministarstvo kulture, omladine i sporta, zasnovano na Akcionom planu za zapošljavanje mladih 2018-2020 kao i na uredbi MF - br - 04/2017 o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja NVO-a, poziva sve nevladine organizacije registrovane u Republici Kosova, program kojih je usredsređen na oblast obrazovanja, da apliciraju za finansijsku podršku za projekte koji doprinose obrazovanju mladih putem neformalnog obrazovanja (obuka, seminara, radionica, okruglih stolova, sajмова, konferencija, studijskih poseta) kao i informalnog obrazovanja.

Glavni cilj ovog javnog poziva jeste promovisanje demokratskih vrednosti i aktivnog građanstva kod mladih, putem globalnog obrazovanja i stvaranja kulture učenja tokom celog života, pružajući mladima sposobnosti i znanja koja su im neophodna da napreduju u što globalnijem društvu.

Povećanje kapaciteta kod mladih, putem neformalnog i informalnog obrazovanja, podržava njihov razvoj, pomažući transformaciju potencijala, kreativnosti, talenta, inicijative i socijalne odgovornosti, putem prisvajanja znanja, stavova i vrednosti.

Nevladine organizacije mogu aplicirati projektom koji doprinosi postizanju ovog specifičnog cilja:

Razvoj sposobnosti i nadležnosti kod mladih putem neformalnog i informalnog obrazovanja i uzgajanje vrednosti, stvarajući stavove za odgovorno građanstvo.

Ove obuke, seminari, debate, okrugli stolovi, sajmovi, konferencije, itd., koristeće se za podržavanje mladih od 15 do 24 godina starosti, kako bi razvili sposobnosti, nadležnosti i stavove u nekim od sledećih tematika:

Tematike:

- Obrazovanje o ljudskim pravima;
- Obrazovanje u lideršipu;
- Obrazovanje za posredovanje i lobiranje;
- Oraganizovanje TEDx, gde se organizuju događaji stila TED-a negde i bilo gde – označavajući ideje započete na lokalnom nivou i praćivanjem istih dalje sve do globalne faze. TEDx događaji se trebaju pripremiti nezavisno od TED konferencija, ali zasnovani na TED formatu i pravilima;
- Obrazovanje za toleranciju, mir i smanjenje konflikta;
- Obrazovanje za demokratsko građanstvo;
- Organizovanje konferencija od kojih pridobijaju mladi;
- Organizovanje sajмова;
- Obrazovanje o sposobnostima komunikacije;
- Obrazovanje o razvijanju tehnika sposobnosti debatanja;
- Sposobnosti kritičkog mišljenja;
- Sposobnosti rešavanja problema;
- Pобољšanje govornih sposobnosti u javnosti (public speaking);
- Saloni.

Ukupan budžet predviđen za ovaj poziv iznosi 50,000 evra i putem njega se planira podržavanje 10 do 15 organizacija.

U skladu sa ovim javnim pozivom, NVO mogu aplicirati samo sa jednim projektom.

NVO koje su tokom 2018 godine već pridobili od OzO-a, nemaju pravo da apliciraju sa projektom.

Opšti kriterijumi za NVO:

Kako bi se kvalifikovali za javnu finansijsku podršku, aplikanti trebaju ispuniti minimalne opšte kriterijume, određene dole navedenim odredbama:

- da budu registrovani kao NVO u skladu sa zahtevima primenljivog zakonodavstva za slobodu pridruživanja u nevladinim organizacijama u Republici Kosova;
- da poseduju fiskalni broj u skladu sa zahtevima poreskog zakonodavstva Republike Kosova;
- da ispune sve obaveze prethodne finansijske podrške, ako su pridobili iz javnih izvora finansiranja;
- da nisu dobili sredstva iz drugih izvora finansiranja za iste aktivnosti; i
- da ne postoji neki konflikt interesa među aplikantima, odnosno predstavnicima/rukovodiocima aplikanta i budžetske organizacije ili javne institucije, kao što je predviđeno primelnjivim zakonodavstvom u Republici Kosova.

Specifični kriterijumi

Kako bi se aplikacija smatrala upotpunjenom i kako bi ista dospela do faze razmatranja sa sadržajnog aspekta, aplikant treba ispuniti i minimalne posebne kriterijume predviđene sledećim odredbama:

- da u roku poziva za predlog projekta preda, koji između ostalog sadrži i podatke o cilju, specifičnim ciljevima (ne opis cilja poziva), aktivnosti, kalendar realizacije, ciljne rezultate, direktnog korisnika i ostale potake u skladu sa odgovarajućim obrascem, određenog javnim pozivom;
- predlog projekta treba biti praćen predlogom budžeta, u skladu sa formatom određenim shodno javnom pozivu i Priručniku za sprovođenje ove uredbe;

- da dostavi podatke ključnog osoblja, navodeći njihove obaveze, podnese njihov CV zajedno sa izjavom o saglasnosti (pre sporazuma) sa njihove strane, o tome da će raditi za projekat;
- da dostavi CV i kopije diploma trenera (minimalno 2 trenera za obuke) zajedno sa izjavom o saglasnosti (pre sporazuma) sa njihove strane, o tome da će raditi za projekat;
- sva dokumentacija treba sadržati jednu fizičku kopiju, zajedno sa elektronskom kopijom na CD-u.

U slučaju neupseha da se ispuni neki od opštih i specifičnih kriterijuma, aplikacija će se smatrati neupotpunjenom, i kao takva se ne može kvalifikovati za finansijsku podršku.

Kriterijumi procene sa sadržnog aspekta:

Tokom razmatranja predloga-projekta, treba se razmotriti sledeće:

1. Da li NVO poseduje dovoljno iskustva i profesionalnih kapaciteta za izvršenje aktivnosti planiranih projektom/programom (uključujući osoblje, uređaje i sposobnost upravljanja budžetom i preporukama za slične projekte)?
2. Da li treneri angažovani u projektu imaju dovoljno iskustva i profesionalnih kapaciteta da sprovede planirane aktivnosti projekta/programa (da li poseduju neophodne sposobnosti i sposobnosti za sprovođenje projekta, kao i znanja u vezi sa pitanjima koja će se obrađivati u ovom javnom pozivu)?
3. Da li unutar NVO-a postoji jasna struktura koja će se baviti menadžiranjem projekta (da li je jasno određena ekipa projekta i dužnosti članova ekipe)?
4. Koliko je predlog-projekta relevantan sa ciljeve i prioritarnе oblasti javnog poziva (da li se projekat odnosi na aktivnosti predviđene u Strategiji za obrazovanje mladih putem neformalnog obrazovanja i prioritarnih politika)?
5. Da li su ciljevi projekta/programa određeni na jasan i realno dosežan način?
6. Da li su ciljevi projekta/programa jasni, razumni, razumljivi i sprovodljivi?
7. Da li su rezultati jasno određeni i da li aktivnosti vode do postizanja rezultata?
8. Da li je projekat/program uspeo da na jasan način odredi korisnike (brojn, starost, rod, regionalni fokus, itd.)? Da li projekat, i u kojoj meri, određuje rešavanje problema i potrebe istih?
9. Da li su troškovi projekta/programa realni što se tiče specifičnih rezultata i očekivanog trajanja projekta?
10. Da li su troškovi projekta u skladu sa planiranim aktivnostima projekta/programa?

Poslednji rok za podnošenje predloga traje do 1 Juna 2018 godine.

Period sprovođenja projekta traje najviše 5 meseci. NVO mogu aplicirati sa najviše jednim (1) projektom za jedan (1) određeni region.

Pravo na apliciranje sa svojim projektima imaju NVO koje su registrovane u registru nevladinih organizacija u Republici Kosova. NVO isto tako trebaju obaviti svoje finansijske transakcije na transparentan način, shodno zakonodavstvu za NVO u Republici Kosova i u skladu sa pravilima računovodstva kao i da ispune svoje ugovorne obaveze prema Ministarstvu kulture, omladine i sporta kao i svih ostalih ponuđača javne finansijske podrške.

Pre potpisivanja ugovora, NVO treba podneti dokaz da osoba odgovorna za NVO i menadžer projekta nisu pod istragom za krivična dela, kao i dokaz da je NVO rešilo bilo koje otvoreno pitanje kada je reč o plaćanju doprinosa i neisplaćenog poreza.

Predlozi će se dostaviti samo u predviđenim obrascima, koji su zajedno sa Uputstvom za aplikante na raspolaganju na veb stranici Ministarstva kulture, omladine i sporta (www.mkrs-ks.org).

Upotpunjeni dokumenti se mogu poslati poštom ili dostaviti lično, na dole navedenoj adresi:

Ministarstvo kulture, omladine i sporta /Odeljenje za omladinu.

Trg Majke Tereze; kancelarija arhive, br. 22; 10000, Priština, Republika Kosova

Štampana dokumentacija, kao i elektronska na CD-u, treba se staviti u zatvoreni koverat sa natpisom (**Apliciranje za projekte za globalno obrazovanje i stvaranje kulture učenja tokom celog života, kao i ime NVO-a**).

Dokumentacija u elektronskoj formi (na CD-a) treba imati isti sadržaj, tj. da bude identična sa štampanom verzijom.

Proces prijema, otvaranja i razmatranja aplikacija, procene aplikacija, ugovaranja, davanje fondova, vreme i način podnošenja žalbi, tretiranje dokumenata i kalendar za sprovođenje javnog poziva, detaljno su razrađeni u **Uputstvu za apliciranje**.

Samo oni projekti koji se prime u okviru roka predviđenog ovim javnim pozivom i oni koji u potpunosti ispunjavaju uslove utvrđene u ovom javnom pozivu, biće uzete u obzir za finansijsku podršku.

MKOS će za sve potencijalne aplikante održati informativnu sesiju: **23 maja 2018, u 11:00 sati – u kancelarijama MKOS/OzO**

Sva pitanja koja se odnose na javni poziv mogu se razjasniti samo putem elektronske pošte, dostavljajući e-mail na: flora.salihu@rks-gov.net



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall :

KONKURS

Titulli i punës: Arkitekt -1 pozitë

Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore- Prizren

Vendi: Prizren

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës dhe Punonjësit Profesional të Trashëgimisë Kulturore Grada VIII

Paga: Paga Fikse

Numri i referencës: 26/2018

I përgjigjet: Drejtorit të QRTK Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të QRTK Prizren , kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve në fushën e Trashëgimisë Kulturore ;
2. Bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me Departamentin e Trashëgimisë Kulturore dhe institucionet tjera të Trashëgimisë Kulturore, për realizimin e objektivave të Qendrës rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren ;
3. Kryen detyrat në fushën e Trashëgimisë Kulturore, me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën e trashëgimisë kulturore, kur kërkohet një gjë e tillë.
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushën e arkitekturës për shkak të interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
2. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
3. Shkathësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit ;
4. Shkathësi hulumtues, analitike, vlerësues dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
5. Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, në shkencat shoqërore, përparësi kanë drejtimet histori, arkitekture, arkeologji, minimum 2 vite përvojë pune profesionale.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 28.05.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi “Nëna Tereze” Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrat 038 211 921 dhe 038 211 449, apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazirajući se na Zakon Rada, Br. 03/L-212 i Uredbu br.05/2011, za određivanje Stepena i Plate za Stvaraoce i Izvođače Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleđa, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Arhitekta -1 pozicija

Institucija: Regionalni Centar za Kulturnu Baštine Prizren

Mesto : Prizren

Funkcionalna kategorija: Stvaraoce i Izvođače Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleđa Grada VIII

Plata: Fiksna Plata

Broj referencije: 26/2018

Nadležnik: Direktor RCKB Prizren

Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Direktora RCKB Prizren, izvršava dole navedene zadatke i odgovornosti:

1. Razija i postiže saglasnost o planovima rada i rokovima sa menadžerom i ostalim profesionalnim stafom, za sprovođenje usluga iz oblasti Kulturne Baštine;
2. U kontinuitetu sarađuje sa Departmanom Kulturne Baštine i ostalim institucijama Kulturne Baštine, za realizovanje objekta Regionalnog Centara za Kulturnu Baštinu- Prizren ;
3. Izvršava zadatke iz oblasti kulturne baštine, sa jednim razumnim stepenom samostalnosti, pod nadzorom i uputstvima, s vremena na vreme;
4. Vrší istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju preporuka za razmatranje, sa najviših nivoa;
5. Učestvuje u radnim grupama rada iz oblasti kulturne baštine, kada se tako nešto zahteva.
6. Komunicira unutar i van institucije za razmenu informacija i razvoj delatnosti iz oblasti arhitekture, iz razloga zajedničkog interesa;
7. Redovno izveštava kod nadzornika oko progressa u vezi prihvaćenih planova rada;
8. Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične profesionalne oblasti, koji se mogu zatevati, na razlozan način, s vremena na vreme.

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Duboko i specijalizovano znanje iz specifične profesionalne oblasti, dobijeno preko univerzitetskog obrazovanja i dotičnih treniranja;
2. Znanje zakona i sprovodljivih pravilnika;
3. Sposobnost u komuniciranju, planiranju i eventualnoj koordinaciji kadrovskog osoblja;
4. Istraživačka, analitička i sposobnost za procenjivanje i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
5. Sposobnost na kompjuteru za aplikacije programa (Word,Excel,Power Point,Access);
6. Univerzitetska diploma u društvenim naukama, prednost imaju pravci istorije, arhitekture, arheologije, minimum 2 godine profesionalnog radnog iskustva.

Procedure konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Vremensko trajanje imenovanja: Imenovanje je na neodređeno vreme.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zadnji datum za apliciranje je: 28.05.2018

Aplikacije koje se šalju preko pošte, sa poštanskom markom, na zadnji dan objave, smatraće se važećim.

Podnošenje aplikacije: Aplikacije se uzimaju sa web stranice MKOS-a i predaju se u kancelariji br. 27 u Ministarstvu Kulture, Omladine i Sporta, Trg “Majka Tereza” br. 44. Za dodatne informacije kontaktirajte brojeve tel. 038 211 921 i 038 211 449, ili web-stranicu <http://www.mkrs-ks.org/>



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte



AUTOSHKOLLA “RITMO – L”

**Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333